# EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XVIII, nr. 5490
E enjte, 31 maj 2018
çmimi 0.40 €


## Miratohet rezoluta për hapjen e kufirit në mes të Kosovës dhe Shqipërisë

FAQE 5




Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"



AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de




FLET PËR "EPOKËN E RE", BILALL SHERIFI FAQE 4-5

# S'ka arsye që Qeveria mos ta çojë mandatin deri në fund

Shefi i grupit parlamentar i Nismës Socialdemokrate, Bilall Sherifi, ka thënë se Qeveria Haradinaj është stabile, duke hedhur poshtë kërkesën e opozitës për zgjedhje të parakohshme. Sipas tij, për dallim nga qeverisjet e kaluara, kjo Qeveri ka një zhvillim sa i përket zgjidhjes së shumë çështjeve në vend. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Sherifi ka theksuar se nuk ka arsye pse kjo Qeveri mos ta çojë mandatin deri në fund. Ai ka thënë se roli i Nismës Socialdemokrate në këtë Qeveri është i jashtëzakonshëm. Duke folur për fazën e fundit të dialogut Kosovë - Serbi, Sherifi ka thënë se Nisma insiston që dialogu të mbetet brenda Qeverisë. Ai ka thënë se Qeveria e Kosovës nuk duhet të heqë dorë nga përgjegjësia kushtetuese që ka në këtë proces

## Kosova dhe Maqedonia pritet të nënshkruajnë 15 marrëveshje



Mbledhja e përbashkët në mes të Qeverisë së Kosovës dhe asaj të Maqedonisë pritet të mbahet shumë shpejt. Kështu ka bërë me dije për gazetën "Epoka e re" zëvendëskryeministri Enver Hoxhaj, i cili ka treguar se në këtë mbledhje pritet të nënshkruhen 15 marrëveshje të cilat i përkasin fushës së drejtësisë, sigurisë, shëndetësisë dhe ekonomisë. Analistët politikë Blerim Reka dhe Imer Mushkolaj kanë mirëpritur mbajtjen e kësaj mbledhje, por kanë kërkuar zbatimin e marrëveshjeve të arritura. Sipas tyre, duhet të ndërmerren hapa konkretë për ta bërë më të lehtë jetesën e qytetarëve në të dyja anët e kufirit FAQE 3



## Fotografitë e artistëve të Kosovës nuk lejohen të hyjnë në Serbi

Autoritetet kufitare serbe nuk kanë lejuar të mërkurën ta kalojnë kufirin disa fotografi të artistëve nga Kosova, të cilët ishin nisur të merrnin pjesë në Festivalin "Mirëdita, Dobar Dan!" që organizohet në Beograd. Pretekst i ndalesës ishin disa fotografi të këngëtares së njohur Eliza Hoxha, në të cilat shiheshin flamurin i Kosovës dhe ai i Shqipërisë FAQE 7

### AKTUALE

KLIENTELIZMI PARTIAK, ARMIK I ZHVILLIMIT F. 11



VALON MURATI

KËRKOHET PËRKRAHJE PËR PROMOVIMIN E TË DREJTAVE TË MALAZIASVE NË KOSOVË F. 2

NIS RENOVIMI I KLINIKËS SË EMERGJENCËS NË QKUK F. 11

### EKONOMI

MPMS-ja RRIT PAGESAT PËR STREHIM TË FËMIJËVE PA PËRKUJDESJE F. 8

NË VJESHTË FILLON AKSIONI PËR PASTRIMIN E KOSOVËS F. 9

### KULTURË

ZONAT E MBROJTURA DHE TË DREJTAT E PAMBROJTURA F. 13

### SPORT

KORENICA: DO TA RIKTHEJMË TITULLIN NË PRISHTINË F. 18

MINISTRI GASHI: NË PRISHTINË DO TË NDËRTOHET QENDRA PËR ARTE MARCIALE F. 18


RENOVA PUTZ
Maqedoni Xhepçisht –Tetovë Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009 +389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM PROJEKTIM SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

SatStyro
Mushnikovë-Prizren-Kosovë
Product of EPS and XPS
Mob.: +377(0) 44 506 815
Tel&Fax.: +381(0) 29 246 030
e-mail: sat_styro@yahoo.com
www.satstyro.com

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan , Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

# Thaçi takoi Schüsselin: Ishte zë i fuqishëm i popullit të Kosovës



Prishtinë, 30 maj - Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, në kuadër të vizitës zyrtare në Austri, ka takuar ish-kancelarin dhe kryediplomatin austriak gjatë viteve të luftës, Wolfgang Schüssel. Në profilin e tij në "Facebook", Thaçi ka shkruar se ish-kancelari dhe kryediplomati austriak Wolfgang Schüssel është një mik i dëshmuar i Kosovës. "Sot ne evokuam kujtime të periudhës së luftës, lirisë dhe shtetndërtimit. Si zëvendëskancelar dhe kryediplomat, Wolfgang Schüssel ishte zë i fuqishëm i popullit të Kosovës, duke mbështetur intervenimin humanitar të NATO-s dhe parandalimin e spastrimit etnik", ka shkruar ai. Sipas Thaçit, si kancelar, Schüssel përkrahu rindërtimin, demokratizimin e institucioneve dhe tranzicionin në Kosovë. "Për këtë mbështetje të madhe në periudhën më kritike për vendin tonë, populli i Kosovës do t'i jetë gjithmonë mirënjohës", ka shtuar Thaçi.

## Kurz: Nuk mund të jap siguri për negociatat

Vjenë, 30 maj - Kancelari i Austrisë, Sebastian Kurz, deklaroi se do të mbështesin Shqipërinë në rrugëtimin e saj për në Bashkimin Evropian. Në një deklaratë për media me kryeministrin Edi Rama, kancelari i Austrisë Sebastian Kurz tha se me kryeministrin shqiptar diskutoi për emigracionin ilegal dhe rrugën nga Shqipëria që po ndjekin klandestinët nga Lindja. "Të gjitha vendet e Ballkanit kanë nevojë për një perspektivë evropiane. Më parë ka pasur tensione për shkak të problemeve etnike apo të tjerave politike. Stabiliteti në Ballkan do të thotë më shumë siguri dhe stabilitet edhe në vendin tonë. Folëm për emigracionin ilegal dhe rrugën nga Shqipëria që po ndjekin klandestinët nga lindja. Dëshiroj ta falënderoj Ramën, që në Shqipëri është gatishmëria për ta luftuar emigracionin ilegal", tha ai.

Kancelari shtoi se "Shqipëria ka nevojë dhe e ka merituar edhe mbështetjen tonë. Rama më kërkoi ta mbështes dhe unë i kam premtuar mbështetje financiare për Shqipërinë dhe vendet e tjera që janë në rrugën e re të Ballkanit për të luftuar emigracionin ilegal. Do ta mbështesim me policë të rinj, por edhe në fusha të tjera", ka thënë ai, kurse për negociatat ai ka thënë se nuk mund të japë siguri të qartë për këtë. "Ka disa shtete që për shkak të problemeve të tyre të brendshme e kanë të vështirë të thonë 'PO', por ka një dëshirë të plotë që Shqipëria ta vijojë rrugën e reformave. Ka një mundësi të mirë që të shkojmë në rrugën e reformave", ka shtuar Kurz.

# Kërkohet përkrahje për promovimin e të drejtave të malaziasve në Kosovë

Në takimin e Këshillit Konsultativ për Komunitete me zyrtarë nga Podgorica, ambasadori i Malit të Zi në Kosovë, Ferhat Dinosha, ka kërkuar përkrahje për promovimin e të drejtave të malaziasve, për përfaqësimin e tyre në institucione publike dhe shoqërore në Kosovë



Prishtinë, 30 maj (ER) - Përfaqësuesit e Sekretariatit të Këshillit Konsultativ për Komunitete kanë pritur në një takim miqësor drejtorin për diasporë në Qeverinë e Malit të Zi, Predrag Mitroviq, ambasadorin Ferhat Dinosha dhe Skender Šarkinovi?, sekretar i parë pranë Ambasadës së Malit të Zi në Kosovë.

Sekretarja e Këshillit Konsultativ për Komunitete, Nafiye Ga?, ka njoftuar mysafirët për mandatin e këtij këshilli, bazën ligjore, aktivitetet e zhvilluara dhe ato të planifikuara etj. Temë e veçantë e këtij takimi ishte përfaqësimi i komunitetit malazias në këtë këshill, me ç'rast Ga?i i ka njoftuar të pranishmit me përbërjen e këtij këshilli. "Roli i dy përfaqësuesve të bashkësisë malaziase Biserka Djurdjeviq dhe Lazar Raduloviq është konstruktiv e bashkëpunues dhe japin vazhdimisht kontributin e tyre shumë të çmuar në grupin punues për çështje të punësimit, ku Raduloviq është kryesues dhe Djurdjevic si anëtare në grupin për çështje të gjuhëve", ka thënë ajo.

Ndërsa drejtori për diasporë në Qeverinë e Malit të Zi, Predrag Mitroviq, ka falënderuar Sekretariatin e Këshillit Konsultativ për Komunitete për mikpritjen dhe për mbështetjen që po e japin edhe institucionet e tjera të Kosovës për komunitetin malazias.

Ndërsa ambasadori i Malit të Zi në Kosovë, Ferhat Dinosha, ka kërkuar përkrahje për promovimin e të drejtave të malaziasve, për përfaqësimin e tyre në institucione publike dhe shoqërore në Kosovë.

Në këtë takim është diskutuar edhe për iniciativën institucionale të mëhershme që komuniteti malazias të bëhet kategori kushtetuese. Të pranishmit janë pajtuar të vazhdohet me bashkëpunimin institucional dhe shkëmbimin e përvojave nëpërmjet vizitave për të mirën e të gjitha komuniteteve dhe shteteve tona mike.

## Historiani Hakif Bajrami i bashkohet Vetëvendosjes

Prishtinë, 30 maj - Historiani i njohur Hakif Bajrami i është bashkuar të mërkurën Lëvizjes Vetëvendosje. Kryetari i kësaj lëvizje, Albin Kurti, ka thënë se libri i Bajramit "Politika e shfarosjes së shqiptarëve dhe kolonizimi serb i Kosovës 1844-1995" është një studim tejet i rëndësishëm. "Sot Lëvizjes Vetëvendosje iu bashkua historiani ynë i njohur, prof. dr. Hakif Bajrami. Libri i tij 'Politika e shfarosjes së shqiptarëve dhe kolonizimi serb i Kosovës 1844-1995' është një studim i përmbledhur tejet i rëndësishëm dhe i vlefshëm. Librat e tij të tjerë të shumtë, prej studimeve mbi aradhet partizane te dëbimi dhe shpërngulja e shqiptarëve për Turqi, për personalitetet kombëtare nga Bedri Pejani te Adem Demaçi, e deri te libri i tij i ndaluar në shtypshkronjë në vitin 1990 'Kosova nga Bujani në Kaçanik', janë lexuar e lexohen vazhdimisht jo vetëm nga brezat e studentëve të historisë", ka shkruar Kurti në llogarinë e vet në "Facebook".



EPOKA E RE
Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ
• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

Mbledhja e përbashkët e Qeverisë së Kosovës dhe Maqedonisë pritet të mbahet së shpejti

# Kosova dhe Maqedonia pritet të nënshkruajnë 15 marrëveshje

Mbledhja e përbashkët në mes të Qeverisë së Kosovës dhe asaj të Maqedonisë pritet të mbahet së shpejti. Kështu ka bërë më dije për gazetën "Epoka e re", zëvendëskryeministri Enver Hoxhaj. Ai ka treguar se në këtë mbledhje pritet të nënshkruhen 15 marrëveshje të cilat i përkasin fushës së drejtësisë, sigurisë, shëndetësisë dhe ekonomisë. Analistët politikë Blerim Reka dhe Imer Mushkolaj kanë mirëpritur mbajtjen e kësaj mbledhje, por kanë kërkuar zbatimin e marrëveshjeve të arritura. Sipas tyre, duhet të ndërmerren hapa konkretë për ta lehtësuar jetën e qytetarëve në të dyja anët e kufirit



EPOKA E RE Shqipe HETEMI

Prishtinë, 30 maj - Zëvendëskryeministri, njëherësh koordinator i organizimit të mbledhjes së përbashkët të Qeverisë së Kosovës dhe asaj të Maqedonisë, Enver Hoxhaj, të mërkurën ka bërë me dije se në ditët në vijim do të caktohet data për mbajtjen e kësaj mbledhje. Ai ka thënë për gazetën "Epoka e re" se tashmë ka përfunduar procesi i identifikimit, negocimit dhe përmbylljes së 15 marrëveshjeve që do të nënshkruhen në mbledhjen e përbashkët të dy qeverive.

"Si koordinator i organizimit të kësaj mbledhje të përbashkët, përgjatë këtyre pesë muajve kam realizuar disa vizita dhe takime në Prishtinë, Shkup e Kaçanik me homologun tim në Maqedoni, zëvendëskryeministrin Bujar Osmani, si dhe kam organizuar disa takime koordinimi me ministra e sekretarë të përgjithshëm brenda Qeverisë së Kosovës. Jam shumë i kënaqur me punën e bërë dhe koordinimin e mirë. Tani kemi përfunduar të gjithë procesin e identifikimit, negocimit dhe përmbylljes së marrëveshjeve që janë nga fusha e drejtësisë, e sigurisë, e shëndetësisë, e ekonomisë e deri te njohja reciproke e patentëshoferëve mes dy vendeve. Janë rreth 15 marrëveshje që pritet të nënshkruhen. Ka mbetur vetëm të caktohet data e mbajtjes së mbledhjes. Besoj se kjo do të ndodhë në ditët në vazhdim. Varet se kur Maqedonia e zgjidh çështjen e emrit me Greqinë. Kjo temë varet nga Maqedonia", është shprehur Hoxhaj.

Ai ka vlerësuar se mbajtja e kësaj mbledhje konfirmon marrëdhëniet e shkëlqyera politike, diplomatike e ekonomike në mes të dy vendeve. "Mbledhja e parë e përbashkët e qeverive të Kosovës dhe Maqedonisë është e para e këtij lloji në historinë më të re politike të dy shteteve fqinje. Ky është një hap tjetër i rëndësishëm që konfirmon marrëdhëniet e shkëlqyera politike, diplomatike e ekonomike mes vendeve tona. Por, mbi të gjitha, flet për rolin konstruktiv që shqiptarët kanë luajtur në vazhdimësi në Maqedoni në mënyrë që ky vend të lëvizë drejt Bashkimit Evropian dhe ne si Qeveri e Kosovës e vlerësojmë këtë qasje jashtëzakonisht shumë", ka theksuar Hoxhaj.

Edhe lideri i Bashkimit Demokratik për Integrim (BDI), Ali Ahmeti, ka thënë për gazetën "Epoka e re" se mbledhja e përbashkët në mes të qeverive të dy vendeve do të mbahet shumë shpejt. "Republika e Maqedonisë ka më së shumti marrëveshje të bashkëpunimit ndërshtetëror të nënshkruara me Republikën e Kosovës. Këto marrëveshje janë në fushën e ekonomisë dhe në fushën e bashkëpunimit të institucioneve. Kurse sa i përket mbledhjes së përbashkët, pres që të mbahet së shpejti, meqë autoritetet e dy vendeve janë duke punuar për këtë. Është çështje kohe dhe besoj se shumë shpejt se do të marrë epilog kjo çështje", ka deklaruar Ahmeti.

## Analistët mirëpresin mbledhjen Kosovë - Maqedoni, kërkojnë zbatim të marrëveshjeve

Njohësi i proceseve politike dhe marrëdhënieve ndërkombëtare në Maqedoni, profesori Blerim Reka, ka thënë për gazetën "Epoka e re" se është për t'u përshëndetur mbajtja e mbledhjes së përbashkët e Qeverisë së Kosovës dhe asaj të Maqedonisë. Ai ka theksuar se kjo jep shpresë se politika e re e jashtme e Maqedonisë ndaj fqinjëve do të reflektojë edhe në shtimin e marrëdhënieve bilaterale me Kosovën në të gjitha fushat. "Bile, kjo duhej bërë shumë më herët. Si fqinjë të parë dhe si dy kryeqytete më të afërta të Ballkanit, Shkupi dhe Prishtina ndajnë orientimin e njëjtë dhe të përbashkët strategjik euroatlantik. Për vetëm një vit, pra po realizohet ajo që nuk ishte realizuar gjatë dhjetë vjetëve të fundit. Kjo jep shpresë se politika e re e jashtme e Republikës së Maqedonisë ndaj fqinjëve, do të reflektojë edhe në shtimin e marrëdhënieve bilaterale me Republikën e Kosovës në të gjitha fushat. Tekefundit, edhe strategjia e re e zgjerimit e BE-së për Ballkanin Perëndimor kërkon marrëdhënie të mira fqinjësore, bashkëpunim rajonal dhe mbylljen e të gjitha kontesteve bilaterale. Fatmirësisht, Kosova dhe Maqedonia nuk kanë asnjë çështje të hapur, madje janë ndër të rrallat vende fqinje të Ballkanit që tash e një dekadë kanë mbyllur edhe demarkacionin e kufirit", është shprehur Reka.

Ai shpreson se pas kësaj mbledhje qeveritë do të ndërmarrin hapa praktikë për ta lehtësuar jetën e qytetarëve në të dyja anët e kufirit dhe për ta bërë atë formal ashtu siç është midis shteteve anëtare të BE-së. "Një nga hapat e parë pa dyshim do të ishte aplikimi i sistemit të një sporteli kufitar midis dy shteteve, duke i eliminuar kontrollet e dyfishta. Hapi tjetër do të ishte fillimi i punimeve nga ana e Maqedonisë të pjesës së autostradës Prishtinë - Shkup në segmentin Shkup - Bllacë. Me këtë jo vetëm se do të shkurtohej koha e qarkullimit reciprok qytetar dhe tregtar, por për kompanitë e Maqedonisë do të 'afrohej' edhe më shumë porti i Durrësit", ka deklaruar Reka.

Edhe njohësi i proceseve politike në Kosovë, Imer Mushkolaj, ka thënë për gazetën "Epoka e re" se mbajtja e mbledhjes së përbashkët Kosovë - Maqedoni është shenjë e vullnetit të mirë politik për bashkëpunim të ndërsjellë. Sipas tij, formalisht është normale të mbahet një mbledhje e tillë jo vetëm me Qeverinë e Maqedonisë, por në përgjithësi me qeveritë e vendeve të rajonit. "Mirëpo është problematike se cili do të jetë rezultati i kësaj mbledhje, çfarë marrëveshje do të arrihen dhe a do të zbatohen? Fatkeqësisht, kemi përvojë jo të mirë me mbledhjet e mbajtura në mes të Qeverisë së Kosovës dhe Qeverisë së Shqipërisë, përkatësisht për realizimin praktik të marrëveshjeve të arritura. Kështu që, kjo mund të jetë një mbledhje kurtuazie, një mbledhje për të treguar vullnet të mirë të bashkëpunimit reciprok, por dyshoj se çfarëdo marrëveshje e arritur, do të zbatohet në praktikë në mënyrë të kënaqshme", ka theksuar Mushkolaj.

Megjithatë, ai ka vlerësuar se me Maqedoninë ka mundësi bashkëpunimi në aspektin kulturor dhe ekonomik për shkak të numrit të madh të shqiptarëve që jetojnë atje. "Logjikisht do të duhej që marrëveshjet e arritura me Shqipërinë të mos jenë problematike për t'u zbatuar sesa me cilindo shtet tjetër. Prandaj dyshoj se mund të jenë të suksesshme në praktikë marrëveshjet që arrihen në mes të dy shteteve", ka deklaruar Mushkolaj. Sipas tij, do të ishte mirë që në këtë mbledhje palët të merren vesh për heqjen e taksës që duhet të paguajnë qytetarët e Kosovës kur udhëtojnë me veturë në Maqedoni. "Secili qytetar i Kosovës që dëshiron të shkojë në Maqedoni me veturë duhet të paguajë një taksë të posaçme. Nëse arrihet një marrëveshje në terma praktike sikur heqja e kësaj takse është në rregull, por nëse arrihen marrëveshjeve çfarë është bërë zakon të arrihen dhe të bëhet një listë e tyre e t'u prezantohen medieve si sukses, është e kotë dhe nuk kalon përtej vullnetit politik për ndërtimin e marrëdhënieve ndërfqinjësore", është shprehur Mushkolaj.

Flet për "Epokën e re", Bilall Sherifi

# S'ka arsye që Qeveria mos ta

Shefi i grupit parlamentar i Nismës Socialdemokrate, Bilall Sherifi, ka thënë se Qeveria Haradinaj është stabile, duke hedhur poshtë kërkesën e opozitës për zgjedhje të parakohshme. Sipas tij, për dallim nga qeverisjet e kaluara, kjo Qeveri ka një zhvillim sa i përket zgjidhjes së shumë çështjeve në vend. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Sherifi ka theksuar se nuk ka arsye pse kjo Qeveri mos ta çojë mandatin deri në fund. Ai ka thënë se roli i Nismës Socialdemokrate në këtë Qeveri është i jashtëzakonshëm. Duke folur për fazën e fundit të dialogut Kosovë - Serbi, Sherifi ka thënë se Nisma insiston që dialogu të mbetet brenda Qeverisë. Ai ka thënë se Qeveria e Kosovës nuk duhet të heqë dorë nga përgjegjësia kushtetuese që ka në këtë proces



EPOKA E RE **Albulena S. MAVRAJ**

**Prishtinë, 30 maj** - Shefi i grupit parlamentar i Nismës Socialdemokrate, Bilall Sherifi, ka hedhur poshtë kërkesën e opozitës që vendi të shkojë në zgjedhje të jashtëzakonshme. Në intervistën dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka theksuar se Qeveria Haradinaj është stabile. Sipas tij, për dallim nga qeverisjet e kaluara kjo Qeveri ka një zhvillim sa i përket zgjidhjes së shumë çështjeve në vend. Sherifi ka theksuar se nuk ka arsye pse kjo Qeveri mos ta çojë mandatin deri në fund. Ai ka veçuar edhe rolin e ministrave të Nismës Socialdemokrate në kuadër të kësaj Qeverie. "Mund të themi se roli i Nismës Socialdemokrate përmes ministrave dhe zëvendëskryeministrit Limaj është i theksuar në këtë Qeveri", ka thënë Sherifi.

Duke folur për tryezat e partive politike, ai ka pohuar se këto tryeza përmirësojnë marrëdhëniet politike pozitë-opozitë, që synim kanë gjetjen e një pajtueshmërie për temat nacionale. Ai ka thënë se tryeza e fundit e ftuar nga Lëvizja Vetëvendosje ishte degraduese për faktin se kishte temë të vetme zgjedhjet. Sa i përket fazës së fundit të dialogut Kosovë - Serbi, Sherifi ka thënë se Nisma insiston që dialogu të mbetet brenda Qeverisë. Ai ka thënë se Qeveria e Kosovës nuk duhet të heqë dorë nga përgjegjësia kushtetuese që ka në këtë proces.

**"Epoka e re":** *Z. Sherifi, çfarë vlerësimi keni për punën e Qeverisë, ku pjesë e saj është Nisma Socialdemokrate?*

**Sherifi:** Qeveria Haradinaj është stabile. Për dallim nga qeverisjet e shkuara ka një zhvillim sa i përket zgjidhjes së shumë çështjeve. Ne mund të ndahemi sa iu përket mendimeve nëse ato mund të jenë vendime të drejta apo jo. E rëndësishme është se kjo Qeveri është duke vepruar dhe funksionuar në funksion të zhvillimit në të gjitha sferat. Pra, ka lëvizje përpara. Unë nuk mund të flas tërësisht në emër të Qeverisë. Mund të flas vetëm në çështjet sa i përket Nismës Socialdemokrate.

**"Epoka e re":** *Si Nismë a keni hapësirë të veprimit në këtë Qeveri?*

**Sherifi:** Ministrat e Nismës në planin e bizneseve dhe prodhimeve vendore kanë bërë përparime. Kanë përmirësuar një mori ligjesh, siç është Ligji për Mbrojtjen e Konsumatorit. Po ashtu, ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale, Skënder Reçica, ka bërë përparime. Z. Reçica ka punuar në drejtimin e jetësimit në praktikë të premtimeve që kanë qenë pjesë e fushatës zgjedhore, njëra ndër to, që çdo familje me asistencë sociale ta ketë nga një të punësuar. Andaj, mund të themi se roli i Nismës Socialdemokrate përmes ministrave dhe zëvendëskryeministrit Limaj është i theksuar në këtë Qeveri. Pra, dinamika në ministritë tona është e jashtëzakonshme. Ju i dini sfidat me të cilat është përballur Ministria e Arsimit, ku tashmë shihet se ka lëvizje përpara sa i përket ndryshimit të cilësisë në arsim, edhe pse kjo fushë, e cila ka pasur sfida ndër vite, ka mundur të rregullohet më parë.

"Epoka e re": Së fundmi, ka një përafrim të bashkëpunimit të partive sa i përket organizimit të tryezave politike. Besoni se këto tryeza do të prodhojnë konsensus kombëtar?

Sherifi: Takimet që po ndodhin përmes tryezave të partive politike përmirësojnë marrëdhëniet politike pozitë-opozitë, për të gjetur një pajtueshmëri apo, siç thuhet, konsensus për temat kombëtare. Për mendimin tim, tryeza e parë dhe e dytë kanë qenë në funksion të idesë fillestare, ndërsa tryeza e tretë e ftuar nga Lëvizja Vetëvendosje ka degraduar sepse është marrë vetëm me temën e zgjedhjeve. Tema e zgjedhjeve do të duhej të ishte e fundit. Fillimisht do të duhej të merreshin me çështjen e dialogut, me Asociacionin dhe me tema të tjera. Kur të zgjidhen të gjitha këto tema atëherë mund të flasim se kur mund të shkojmë në zgjedhje.

**"Epoka e re":** *A do të mund ta çojë kjo Qeveri mandatin deri në fund?*

**Sherifi:** Për mendimin tonë kjo Qeveri do të shkojë deri në fund. S'ka asnjë arsye të ndërpritet mandati.

**"Epoka e re":** *Meqë e përmendet dialogun me Serbinë si temë nacionale, pse Nisma*

# çojë mandatin deri në fund



*është kundër që presidenti Thaçi ta udhëheqë këtë dialog?*
**Sherifi:** Nisma Socialdemokrate vazhdimisht ka insistuar dhe insiston që dialogu të mbetet brenda Qeverisë. Ne nuk jemi kundër idesë që dialogu të fillojë simbolikisht ndërmjet dy presidentëve dhe në fund të përfundojë me atë që quhet "Handshaking". Pra, t'ia japin dorën njëri-tjetrit dhe të nënshkruajnë. Qeveria e Kosovës nuk duhet të heqë dorë nga përgjegjësia kushtetuese që ka, kurse në fund, pse jo, le t'i marrë meritat presidenti, nëse i ka mbetur aq shumë tek marrja e meritave në fazën e fundit të dialogut. Nuk mendoj se presidenti duhet të jetë ai që duhet të shkojë për t'i negociuar detajet e përditshme, të mërzitshme dhe të lodhshme që i ka një proces dialogues.

**"Epoka e re":** *Po çështja e themelimit të Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe, sa do të jetë sfiduese për Qeverinë?*
**Sherifi:** Tani kur jemi në fazën finale të dialogut, le të hyjë edhe Asociacioni në kuadër të këtij procesi dhe le të shohim se çfarë duhet të bëjmë ne në bisedime. Ajo çfarë duhet të bëjmë ne është se duhet të vazhdojmë të jemi të hapur ndaj interesave të serbëve të Kosovës, por në asnjë rast që të jenë interesat e Serbisë në Kosovë. Ata duhet ta njohin Republikën e Kosovës si shtet të pavarur.

**"Epoka e re":** *Problem vazhdon të mbetet edhe çështja e të pagjeturave. Do të duhej që kjo çështje të jetë pjesë e fazës së fundit të dialogut?*
**Sherifi:** Janë shumë çështje të cilat duhet të shtrohen në tavolinë. Çështja e të pagjeturve është humane dhe e një rëndësie të veçantë strategjike për vendin, pasi familjet e të pagjeturve duhet të gjejnë qetësi më në fund. Serbia e ka për detyrë ose të themi parakusht këtë çështje. Pra, janë disa çështje të cilat mund të shënojnë parakushte për t'i filluar bisedimet dhe jo të lihen vetëm si pjesë e bisedimeve. Mbi të gjitha, çdo marrëveshje duhet të lidhet me njohjen e pashmangshme të Kosovës nga ana e Serbisë. Asnjë marrëveshje e cila në fund nuk e ka njohjen e Kosovës nuk do të na sjellë asgjë pozitive.

**"Epoka e re":** *Në mbledhjen e fundit të Qeverisë nga dy ministra të PDK-së u kundërshtua krijimi i Zonës Ekonomike në Malishevë. Pse kjo përplasje mes partnerëve të koalicionit?*
**Sherifi:** Sa unë pashë, më shumë ishte kërkim i qartësimit të mëtejmë sesa kundërshtim. Besoj se ministrit të cilit i është kërkuar sqarim do t'i sjellë ato dhe në fund nuk do të kemi kundërshtime sa i përket kësaj zone. Nëse fillojmë me këtë logjikë atëherë humbet kuptimi edhe i vazhdimit të një qeverisje të përbashkët, duke penguar projektet e ministrave të partive të tjera. Besoj se nuk ka pasur ndonjë qëllim. Shpresoj se kjo të sqarohet në ditët në vijim.

**"Epoka e re":** *Si e shihni ritmin e punës së Kuvendit, meqë ishit propozues që Kuvendit ta përfundojë seancën pa ndërprerje?*
Sherifi: Problemi është se agjenda e Kuvendit është e ngarkuar me debate dhe interpelanca. Debatet mund të zhvillohen edhe pa prani të kryeministrit, por për interpelanca është e domosdoshme që kryeministri të jetë i pranishëm. S'kanë mundur të harmonizohen agjendat në mes të kërkuesve të interpelancave dhe kryeministrit. Meqë s'kanë mundur të harmonizohen agjendat, është ngarkuar shumë rendi i ditës i seancave të Kuvendit. Unë kërkova që Kuvendi të hyjë në seancë të pandërprerë me 75 pika të rendit të ditës, sepse nëse vazhdojmë me ritme javore, atëherë janë 10 javë që marrin debate dhe interpelanca, që i bie dy muaj e gjysmë plus. Pastaj është muaji gusht, muaji i pushimit. Kështu që, do të mbesim deri në dhjetor me këto pika të rendit të ditës së Kuvendit.

# Miratohet rezoluta për hapjen e kufirit në mes të Kosovës dhe Shqipërisë

**Prishtinë, 30 maj (ER)** - Me 73 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim, deputetët e Kuvendit të Kosovës kanë miratuar të mërkurën propozimrezolutën për hapjen e tërësishme të kontrollit për hyrje-daljet e shtetasve të Kosovës dhe Shqipërisë nëpërmjet pikave të kalimit kufitar në Vërmicë, Qafë Prush dhe Qafë Morinë. Ky propozim është bërë nga deputeti i Partisë Socialdemokrate (PSD) PSD-së, Dardan Molliqaj. Po ashtu, Kuvendi i Kosovës ka miratuar edhe rezolutën e propozuar nga grupi parlamentar i PSD-së që parasheh heqjen e roamingut mes Kosovës dhe Shqipërisë.
Deputeti i kësaj partie, Dardan Molliqaj, ka falënderuar deputetët e Kuvendit për votimin e kësaj rezolute. "Nga tash Kosova dhe Shqipëria pa roaming. Falënderoj të gjithë deputetët që votuan rezolutën që e paraqita në emër të PSD-së për ta hequr roamingun në mes të Kosovës dhe Shqipërisë. Tash e tutje do të komunikojmë me njëri-tjetrin sikurse brenda vendit, pa shpenzime shtesë. Shpresoj se Qeveria e Kosovë do t'i fillojë punimet sa më shpejt për zbatimin e plotë të kësaj rezolute të votuar nga Kuvendi i Kosovës. Urime të gjithëve!", ka shkruar Molliqaj
Kuvendi i Kosovës ka miratuar edhe programin për zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit (MSA). Në favor të kësaj marrëveshje kanë votuar 71 deputetë, një kundër dhe katër kanë abstenuar. Po ashtu, deputetët e Kuvendit kanë miratuar edhe Strategjinë Shtetërore të Ujërave në Kosovë 2017-2036. Kjo strategji ka marrë 66 vota të deputetëve.



# INDEP-ja propozon që agjencitë e pavarura të japin llogaridhënie

EPOKA E RE Faton DERMAKU

PRISHTINË, 30 MAJ - Instituti për Politika Zhvillimore (INDEP) ka organizuar të mërkurën tryezën diskutuese "Agjencitë e pavarura dhe reforma e shumëpritur - ekzistimi, funksionimi dhe rekrutimi". Pjesëmarrës në këtë tryezë ishin përfaqësues të Kuvendit që merren me agjenci të pavarura dhe përfaqësues të shoqërisë civile.

Në hapje të tryezës drejtori ekzekutiv në INDEP, Burim Ejupi, ka theksuar nevojën e domosdoshme që ka reformimi i agjencive të pavarura në drejtim të bërjes së tyre më funksionale. "Kuvendi i Kosovës nuk duhet të jetë vend ku përmes pazareve politike zgjidhen anëtarë jomeritorë në borde. Përkundrazi, ai duhet të shërbejë si një mekanizëm konfirmimi i personave që procesi i konkursit ia filtruar si më profesionalët", ka thënë Ejupi.

Në panelin diskutues ishte edhe Fehmi Pireva, zyrtar ndërlidhës i Kuvendit për Agjencitë dhe Institucionet e Pavarura. Ai ka folur për sfidat e shumta me të cilat përballet Kuvendi për përmbushjen e rolit mbikëqyrës ndaj agjencive të pavarura. "Ende kam shumë pyetje rreth të cilave nuk kam përgjigje definitive sa i takon numrit të agjencive, numrit të anëtarëve të bordeve, kompetencave të ndryshme etj. Shpresoj shumë se kjo tryezë dhe të tilla të ngjashme t'u japin përgjigje këtyre temave", ka theksuar Pireva.

INDEP-ja në këtë tryezë ka publikuar dy punime "Rishikimi i agjencive të pavarura me qëllim racionalizimin e funksioneve dhe ngritjen e performancës" dhe "Rregullimi ligjor i agjencive të pavarura" të cilat u prezantuan nga eksperti i jashtëm i Institutit, Jeton Oruçi.

Përmes këtyre dy analizave INDEP-ja ka propozuar tri faza për reformimin e agjencive të pavarura. Në fazën e parë INDEP-ja propozoi bartjen nga agjenci të pavarura në dikastere qeveritare të, së paku, këtyre agjencive: Akademisë së Drejtësisë, Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore, Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale, Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas, Agjencisë për Krahasim dhe Verifikim të Pronës, Agjencisë Kosovare të Privatizimit dhe Akademisë së Arteve dhe Shkencave të Kosovës.




Këto agjenci, sipas INDEP-së, përveçse kryejnë funksione ekzekutive, janë vetëm barrë buxhetore dhe mbikëqyrëse për Qeverinë, përkatësisht Kuvendin. Si të tilla, ato duhen shkrirë në ministri, departamente dhe dikastere të tjera qeveritare. INDEP-ja gjithashtu ka propozuar analizimin dhe fuzionimin e një pjese të agjencive të pavarura dhe mundësinë e bashkimit të disa rregullatorëve në bazë të funksioneve.

# Bashkëpunimi ndërkomunal rrit potencialin për zhvillim ekonomik lokal

SHKUP, 30 MAJ (ER) - Në ditën e tretë të trajnimit modular që po zhvillohet në Republikën e Maqedonisë, u trajtua dhe adresua roli i bashkëpunimit ndërkomunal në ofrimin e shërbimeve, nxitja e zhvillimit rajonal dhe promovimi i tyre nga mediat. Ligjërues në këto sesione të ndara ishin Besnik Muçaj, ushtrues detyre i drejtorit ekzekutiv Institutit Kosovar për Qeverisje Lokale (KLGI), Trim Berisha, udhëheqës i Departamentit për Bashkëpunim dhe Zhvillim Rajonal nga MAPL dhe Kaltrina Ajeti, drejtoreshë ekzekutive e Institutit Kosovar të Mediave dhe Komunikimit.




Përfituesit e këtij programi të avancuar fillimisht u njoftuan me qasjen e aspektit legjislativ dhe institucional lidhur me konceptin e bashkëpunimit ndërkomunal. Njëherësh, fokus i veçantë u vendos mbi procesin dhe procedurat e iniciativave për bashkëpunim ndërkomnal, nisur nga arsyetimi dhe prioritetet për nevojë të bashkëpunimit në mes të dy apo më shumë komunave, dërgesa për aprovim te kuvendet komunale (me shumicë të votave), fillimi i negociatave në mes të institucioneve përkatëse e deri tek vlerësimi i ligjshmërisë së marrëveshjes dhe hyrjes në fuqi.

Marrë parasysh rolin e bashkëpunimit në mes të dy apo më shumë komunave, është tejet e rëndësishme që këto forma të bashkëpunimit të jenë efikase edhe në implementim, duke mos mbetur vetëm në letër. Njëkohësisht, komunikimi i zyrtarëve për informim me mediet lokale dhe qendrore është një nga mekanizmat efektivë për t'i promovuar aktivitetet e komunave dhe sukseset/praktikat e mira të arritura përmes bashkëpunimeve ndërmjet komunave. Ky komunikim duhet të jetë dykahësh, ku duhet të vendosen caqet dhe objektivat se çfarë duhet të prezantohet para publikut.

Në fund të sesioneve trajnuese, pjesëmarrësit përmes punës në grupe shkëmbyen përvojat dhe modelet në komunat përkatëse, njëherësh përmes punës praktike bënë identifikimin e fushave të bashkëpunimit ndërkomunal, përfitimet në ofrimin e shërbimeve dhe projektet e përbashkëta përmes bashkëpunimit ndërkomunal.

## Nis renovimi i Klinikës së Emergjencës në QKUK

PRISHTINË, 30 MAJ (ER) - Ministri i Shëndetësisë, Uran Ismaili, ka bërë me dije se ka nisur renovimi i Klinikës së Emergjencës në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës (QKUK). Ismaili ka thënë se shumë shpejt kjo klinikë do të transformohet në një vend të denjë për ofrimin e shërbimeve për qytetarët. "Klinika e Emergjencës në QKUK është një ndër klinikat më të ngarkuara gjatë ditës. Qindra qytetarë tanë nga i gjithë vendi kërkojnë ndihmë mjekësore për problemet e tyre aty. Megjithatë, ka kohë që kjo klinikë është në gjendje jo të mirë dhe nuk ka pasur asnjë investim në të. Ditë më parë kemi nisur rinovimin dhe blerjen e pajisjeve të shumta që kanë munguar në këtë klinikë. Shumë shpejt kjo klinikë do të transformohet në një vend më të denjë për ofrimin e shërbimeve për qytetarët tanë", ka shkruar Ismaili në llogarinë e vet në "Facebook".



Serbia vazhdon të veprojë kundër frymës së dialogut në raport me Kosovën

# Fotografitë e artistëve të Kosovës nuk lejohen të hyjnë në Serbi

**Autoritetet kufitare serbe nuk kanë lejuar të mërkurën ta kalojnë kufirin disa fotografi të artistëve nga Kosova, të cilët ishin nisur të merrnin pjesë në Festivalin "Mirëdita, Dobar Dan!" në Beograd. Pretekst i ndalesës ishin disa fotografi të këngëtares së njohur Eliza Hoxha, në të cilat shiheshin flamuri i Kosovës dhe i Shqipërisë. Fotografitë që ishin paraparë të ekspozoheshin në kuadër të këtij festivali janë cilësuar të papranueshme nga autoritetet serbe dhe janë ndalur**




EPOKA E RE Muhamet KOCI

PRISHTINË, 30 MAJ - Policia kufitare e Serbisë ka ndalur të mërkurën në Merdare një grup të artistëve nga Kosova të cilët ishin nisur të merrnin pjesë në Festivalin "Mirëdita, Dobar Dan!" në Beograd. Artistët e Kosovës për disa orë ishin kontrolluar në detaje nga autoritetet serbe dhe më pas janë liruar. Pretekst i ndalesës ishin disa fotografi të këngëtares së njohur Eliza Hoxha, në të cilat shiheshin flamuri i Kosovës dhe i Shqipërisë. Fotografitë që ishin paraparë të ekspozoheshin në kuadër të festivalit janë cilësuar të papranueshme nga autoritetet serbe dhe janë ndalur, duke përfshirë edhe katalogun e këngëtares që pritej të ekspozohej në festival. "Fotot edhe mund t'i ndalin, por realitetin nuk mund ta ndërrojnë", ka shkruar Eliza Hoxha në profilin e vet në "Facebook".

Ndaj këtyre veprimeve të Serbisë kanë reaguar udhëheqësit e shtetit të Kosovës. Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka thënë se sjellja e autoriteteve të Serbisë është në kundërshtim të frymës së bashkëpunimit që po ndërtojnë në rajon. "Pengesat e policisë serbe dhe të autoriteteve të qytetit të Beogradit kanë vënë në pikëpyetje organizmin e kësaj ngjarjeje kulturore. Arti, kultura, sporti nuk duhet të pengohen nga politika, veçanërisht kur angazhohen për paqe e pajtim. Për më tepër, kjo sjellje e autoriteteve të Serbisë është në kundërshtim të frymës së bashkëpunimit që po ndërtojmë në rajon dhe në kundërshtim me përpjekjet për të vënë raporte evropiane në mes vendeve të rajonit. Kjo bëhet edhe më e rëndë pas mesazheve të qarta të dhëna në Samitin e Sofjes në mes të BE-së dhe vendeve të Ballkanit Perëndimor, se vendet e Evropës Juglindore nuk kanë të ardhme evropiane pa ndërtim dhe normalizim të marrëdhënieve të mira ndërfqinjësore", ka shkruar Thaçi në profilin e vet në "Facebook".



Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, e ka quajtur veprim të ulët ndalimin e artistëve të vendit tonë nga autoritetet e Serbisë. "Në Merdar ndalohen artistët kosovarë, duke shkuar në Beograd, për të dhënë mesazhe të dialogut e të komunikimit. Ajo që i ndodhi sot Eliza Hoxhës, e cila vetëm pak ditë më parë prezantoi Kosovën në Bienalen e Venecias, është veprim i ulët i shtetit serb. Në Beograd sulmohet brutalisht edhe intelektuali me famë botërore, Bernard Henri Levi, sepse mbrojti kauzën për liri të popullit të Kosovë më 1999. Atje ende kanë frikë nga e vërteta dhe arti. Por, fuqia e artit është më e madhe sesa ndalesat kufitare", ka shkruar Veseli në llogarinë e vet në "Facebook".

Ndërsa kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka thënë se Serbia është duke minuar normalizimin e marrëdhënieve me Kosovën. "Autoritetet serbe me aktin e ndalesës në kufi të artistëve kosovarë, të ftuar në Festivalin 'Mirëdita, Dobar Dan!', në Beograd, po rrënojnë edhe ato pak mundësi për vendosjen e një komunikimi normal me Kosovën, qoftë edhe përmes artit, si gjuhë universale. Artistët dhe të rinjtë nga Kosova po i nënshtrohen bastisjes së rreptë në kufi me Serbinë, ku policia serbe ua ka bërë me dije se dy ekspozita nuk do të lejohen për shkak të përmbajtjeve artistike të tyre. Me pengimin e lëvizjes së lirë të njerëzve dhe ideve, Serbia po e minon normalizimin e marrëdhënieve me Kosovën, që është në kundërshtim me frymën dhe vlerat evropiane", ka shkruar Haradinaj në llogarinë e vet në "Facebook".

Festivali "Mirëdita, Dobar Dan!", që sivjet mbahet për të pestin vit më radhë, sjell artistë, gazetarë dhe figura publike nga Kosova në Beograd, për t'u takuar me anëtarë të shoqërisë civile në Serbi dhe organizata kulturore.

# Kontrollohet Burgu i Dubravës

PRISHTINË, 30 MAJ (ER) - Autoritetet e sigurisë kanë organizuar të mërkurën një kontroll në Qendrën Korrektuese në Dubravë për t'i evituar disa tentativa për furnizim të personave në vuajtje të dënimit me materiale të ndaluara.




Ministri i Drejtësisë, Abelard Tahiri, ka thënë se masat parandaluese ndaj dukurive negative brenda qendrave korrektuese janë duke dhënë rezultate konkrete dhe pa dyshim se do ta rrisin nivelin e sigurisë brenda sistemit korrektues. "Sot është organizuar një kontroll në Qendrën Korrektuese në Dubravë, në të cilin autoritetet përgjegjëse të sigurisë kanë evituar disa tentativa për furnizim të personave në vuajtje të dënimit me materiale të ndaluara", ka thënë Tahiri.

Ai ka theksuar se zbatimi i rendit dhe sigurisë brenda sistemit korrektues është kusht i domosdoshëm për realizimin e mandatit të Shërbimit Korrektues të Kosovës. "Ky aksion është në funksion të zbatimit të legjislacionit në fuqi dhe politikave konkrete që kemi ndërmarrë për funksionimin sa më të mirë dhe profesional të Shërbimit Korrektues të Kosovës. Krahas respektimit të të drejtave dhe dinjitetit të personave në vuajtje të dënimit, zbatimi i duhur i rendit dhe sigurisë brenda sistemit korrektues është kusht i domosdoshëm për realizimin e mandatit të Shërbimit Korrektues të Kosovës, i cili çdo ditë e më tepër po avancon drejt profesionalizmit, sigurisë dhe respektimit të integritetit të personave në vuajtje të dënimit. Policia e Kosovës edhe gjatë këtij aksioni dëshmoi edhe një herë profesionalizmin e lartë të saj, për çfarë e falënderoj përzemërsisht", ka thënë ministri Tahiri.

# MPMS-ja rrit pagesat për strehim të fëmijëve pa përkujdesje

**Rritja e pagesës së rregullt mujore për strehim familjar për fëmijë pa kujdes prindëror të strehuar brenda familjes biologjike do të bëhet 100 euro, nga 75 euro sa ka qenë deri më tani. Rritje të pagesës mujore do të ketë edhe për strehim të fëmijëve me aftësi të kufizuara, të strehuar jashtë familjes biologjike. Nga 250 euro sa ka qenë deri më tani, kjo rritje do të bëhet në 350 euro**



EPOKA E RE A. MAVRAJ

PRISHTINË, 30 MAJ - Në prag të 1 Qershorit, Ditës Ndërkombëtare të Fëmijëve, ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale, Skender Reçica, ka marrë vendim për rritje të pagesës mujore të strehimit familjar për fëmijë pa përkujdesje si dhe për fëmijë me aftësi të kufizuara. Duke marrë parasysh shqetësimet dhe kërkesat e familjeve strehuese, se kostoja e shpenzimeve për kujdesin e këtyre kategorive të fëmijëve është rritur, ndërsa shuma aktuale të mbështetjes së familjeve që paguhet nga MPMS-ja për këtë formë të mbrojtjes së fëmijëve është e pamjaftueshme, Reçica ka marrë vendim për rritje të pagesës së strehimit familjar, e cila do të fillojë së zbatuari nga 1 qershori i këtij viti (2018).

Rritja e pagesës së rregullt mujore për strehim familjar për fëmijë pa kujdes prindëror të strehuar brenda familjes biologjike do të bëhet 100 euro, nga 75 euro sa ka qenë deri më tani dhe do të përfitojnë mbi 550 fëmijë. Gjithashtu, nga 150 në 250 euro do të rritet pagesa e rregullt mujore e strehimit familjar edhe për fëmijë të strehuar jashtë familjes biologjike. Rritje të pagesës mujore do të ketë edhe për strehim të fëmijëve me aftësi të kufizuara, të strehuar jashtë familjes biologjike. Nga 250 euro sa ka qenë deri më tani, kjo rritje do të bëhet në 350 euro.

Kurse shuma e pagesës fillestare për strehim familjar për fëmijë të strehuar jashtë familjes biologjike dhe e strehimit familjar për fëmijë me aftësi të kufizuara të strehuar jashtë familjes biologjike do të vazhdojë të paguhet në vlerë prej 75 eurosh, e cila paguhet vetëm një herë, me rastin e strehimit të fëmijës në familje.

# Hasani: Metrologjia, shtyllë kryesore për infrastrukturë të cilësisë




PRISHTINË, 30 MAJ (ER) - Ministri i Tregtisë dhe Industrisë, Bajram Hasani, në Ditën Botërore të Metrologjisë, ka thënë se metrologjia është ndër shtyllat kryesore të MTI-së për shkak të punëve që i kryen.

Hasani në konferencën që është organizuar nga MTI-ja për Ditën Botërore të Metrologjisë, ka theksuar se që nga fillimi i punës së tij si ministër i ka kushtuar rëndësi të madhe metrologjisë. "Jemi shumë të vendosur që metrologjia ta luajë rolin e vet, sepse është një prej shtyllave kryesore për shkak të matjeve, kalibrimeve dhe rëndësisë që ka. Metrologjia, akreditimi dhe standardizimi kanë nevojë për mbështetje më të fuqishme, dhe jemi të përkushtuar që ta përafrojmë dhe harmonizojmë legjislacionin tonë me atë të Bashkimit Evropian. Pra, që të krijohet një infrastrukturë e cilësisë sa më e mirë, që bizneset tona të jenë konkurrente edhe në tregjet e huaja", ka thënë ministri Hasani.

Ai ka bërë me dije se Ligji për këtë agjenci ka hyrë në fuqi dhe parasheh 35 udhëzime administrative. Në këtë drejtim, Hasani beson se shumë shpejt do të formohen grupet punuese. "Ne jemi të vendosur që këto t'i shtyjmë përpara dhe ligji të jetë sa më funksional. Falënderojmë edhe Komisionin Evropian që na ka ndihmuar shumë në fushën e meteorologjisë me asistencë teknike, atë të akreditimit dhe standardizimit. Po presim të kemi punë konkrete edhe me një projekt të Bankës Botërore që ka filluar dhe shumë shpejt do të nisin investimet në laboratorët përkatës. Është një vlerë prej 14.3 milionë dollarësh dhe një pjesë e kësaj shume do të shkojë për meteorologji. Kjo tregon se i kemi kushtuar shumë rëndësi metrologjisë, sepse është një fushë kryesore e cilësisë", ka thënë Hasani.

Ministri ka theksuar se sistemi metrologjik i Kosovës është pjesë e infrastrukturës kombëtare teknike të cilësisë. "Cilësia e shërbimeve metrologjike të konfirmuara me anë të akreditimit është baza për cilësinë e produkteve dhe shërbimeve kosovare. Ministria e Tregtisë dhe Industrisë dhe Agjencia e Metrologjisë së Kosovës me politikat e tyre dhe objektivat e ndërtimit të sistemit të metrologjisë synojnë të sigurojnë shërbime metrologjike sa më profesionale e cilësore, në kuadër të laboratorëve ekzistues të cilët janë nën menaxhimin e AMK-së", ka thënë Hasani.

# Në vjeshtë fillon aksioni për pastrimin e Kosovës

EPOKA E RE Arbisa SHEFKIU




**Prishtinë, 30 maj** - "Ftoj të gjithë, institucionet e BE-së, të gjithë partnerët, KFOR-in, FSK-në, Policinë, Zjarrfikësit, njësitë rajonale dhe regjionale të pastrimit të mbeturinave, të bëhen bashkë, që në vjeshtë ta bëjmë një pastrim gjeneral në Kosovë, prej mbetjeve nga mbeturinat që janë bërë që 20 vjet", ky ishte mesazhi i kryeministrit Haradinaj në ditën e parë të Konferencës së Nivelit të Lartë mbi Zhvillimin e Qëndrueshëm që i dedikohet mjedisit dhe e cila ka nisur sot në Prishtinë.

Në fjalën e tij kryeministri Haradinaj ka thënë se gjendja në Kosovë nuk është e kënaqshme sa iu përket çështjeve mjedisore, por ky është momenti i fundit kur ne duhet të reagojmë. "Është koha e fundit kur ne duhet ta kuptojmë rëndësinë e mbrojtjes së ambientit", ka thënë Haradinaj, duke shtuar se mungesa e hapësirave të gjelbra në vendet urbane dhe ndotja e ajrit janë çështje që na shqetësojnë vazhdimisht.

Kryeministri ka falënderuar me këtë rast Komisionin Evropian dhe organizatat e tjera ndërkombëtare, të cilët në vazhdimësi kanë ndihmuar me fonde, donacione dhe grante, në projektet që i dedikohen ambientit dhe përmirësimit të tij. "Miqtë tanë ndërkombëtarë na kanë ndihmuar ta fillojmë jetën në kushte emergjente pas shkatërrimeve që kanë ndodhur në vitin '99 dhe tani po vazhdojnë të na mbështesin në përmirësimin e ambientit", ka deklaruar kryeministri Haradinaj.

Ndërsa përfaqësuesja e posaçme e BE-së në Kosovë, Natalyia Apostolova, ka thënë se resurset natyrore të Kosovës janë të limituara dhe duhet të shfrytëzohen në mënyrë të duhur. "Kosova duhet ta ndryshojë qasjen sa i përket mbrojtjes së ambient. Zhvillimi i qëndrueshëm është pjesë e integrimit të Kosovës në BE", është shprehur Apostolova, duke shtuar se 50 milionë euro nga BE-ja janë investuar në projekte për mjedisin në dhjetë vjetët e fundit.

Ndërkaq ministrja e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Albena Reshitaj, ka thënë se është hera e parë që jo vetëm në Kosovë, por edhe në rajon po organizohet një konferencë e tillë që i dedikohet mjedisit. "Do të luftojmë me të gjitha forcat tona që të mos kemi këtë degradim të mjedisit dhe do të krijojmë një Kosovë, një mjedis që do të jetë shembull për rajonin", ka thënë ministrja Reshitaj.

Me një fjalë, të pranishmëve u është drejtuar edhe Ulrike Lunaçek, ish-zëvendëspresidente e Parlamentit Evropian dhe ish-raportuese për Kosovë, e cila inkurajoi institucionet dhe aktorët e tjerë të angazhohen për ta përmirësuar gjendjen në ambient. Pjesëmarrës të tjerë në këtë konferencë ishin edhe kryetarë komunash, ambasadorë të akredituar në Kosovë dhe ekspertë të mjedisit.

Konferenca njëjavore e nivelit të lartë për zhvillim të qëndrueshëm organizohet nga Qeveria e Kosovës në bashkëpunim me Zyrën e BE-së në Kosovë dhe KOSID.

Për të ndikuar në përmirësimin e mjedisit në Kosovë, për herë të parë, krahas nismave legjislative dhe projekteve konkrete, qeverisja Haradinaj ka ndarë mjete prej 10 milionë eurosh për menaxhimin e mbeturinave.

# Deutsche Bundesbank do ta përkrahë BQK-në



**Frankfurt, 30 maj (ER)** - Guvernatori i Bankës Qendrore të Kosovës (BQK), Fehmi Mehmeti, gjatë vizitës në Frankfurt të Gjermanisë, ka takuar zëvendëspresidentin, njëherësh anëtarin e Bordit ekzekutiv të Deutsche Bundesbank, dr. Johannes Beermann.

Në takimin e zhvilluar guvernatori Mehmeti e ka informuar zëvendëspresidentin e Deutsche Bundesbankës, Beermann, me zhvillimet e fundit në ekonominë dhe sistemin financiar në Republikën e Kosovës.

Guvernatori Mehmeti ka shprehur falënderimet më të sinqerta për bashkëpunimin dhe përkrahjen e vazhdueshme që Deutsche Bundesbank dhe Qeveria e Gjermanisë i kanë dhënë BQK-së dhe Republikës së Kosovës në përgjithësi, me shpresën se ky bashkëpunim dhe përkrahje do të vazhdojë edhe në të ardhmen.

## Studentëve të AAB-së u mundësohet mësimi praktik në Postë

**Prishtinë, 30 maj (ER)** - Drejtori i Postës së Kosovës, Sejdi Hoxha dhe rektori i Kolegjit AAB, Luzim Tafa, kanë nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi e cila do t'u mundësojë studentëve të këtij kolegji kryerjen e mësimit praktik në Postë. Me këtë rast, Hoxha ka thënë se Posta e Kosovës është në shërbim të të gjithë qytetarëve. "Jam i lumtur që sot i hapëm dyert për studentët e Kolegjit AAB që ta mbajnë mësimin praktik në Postën e Kosovës. Të gjitha institucionet e kanë obligim të krijojnë kushte sa më të mira për ngritjen profesionale të studentëve tanë. Posta ka marrëveshje të tilla me institucione të ndryshme universitare dhe parauniversitare. Ndërmarrja jonë publike është në shërbim të të gjithë qytetarëve. E falënderoj rektorin Lulëzim Tafa për këtë projekt të përbashkët! Urime të gjithë studentëve të Kolegjit AAB!", ka shkruar Hoxha në llogarinë e vet në "Facebook".



# Kryetari i rinisë së AAK-së në Ferizaj i bashkohet Nismës

FERIZAJ, 30 MAJ (ER) - Nismës Socialdemokrate të mërkurën në Ferizaj zyrtarisht iu bashkua Mentor Ibishi, kryetar i rinisë i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, Dega Ferizaj. "Po shkruaj për të njoftuar zyrtarisht për dorëheqjen time nga posti i kryetarit të Aleancës së të Rinjve të Kosovës, Dega Ferizaj. Duke marrë parasysh gjendjen në Degën e AAK-së në Ferizaj, ndihem i zhgënjyer që i gjithë ky kontribut dhe mund u vë në shërbim të një grupi individësh. Mosgatishmëria e vazhdueshme e degës edhe më parë ka rezultuar me dorëheqje", ka shkruar Ibishi në llogarinë e vet në "Facebook". Ai ka theksuar se duke parë shumë anashkalime, mosrespektim dhe mostrajtim të mirëfilltë ndaj tij si kryetar dhe anëtarëve të rinisë, ka marrë vendim për t'u larguar nga AAK-ja. "Nga sot zyrtarisht do të jem pjesë e subjektit Nisma Socialdemokrate", ka shkruar Mentor Ibishi.






# Bëhen përgatitjet për shënimin e 140-vjetorit të Lidhjes së Prizrenit

PRIZREN, 30 MAJ (ER) - Kryetari i Komunës së Prizrenit, Mytaher Haskuka, ka bërë me dije se për nder të 140-vjetorit të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit kjo komunë do të organizojë aktivitete të ndryshme kulturore dhe sportive. "34 vjet para themelimit të Shqipërisë dhe 130 para pavarësimit të Kosovës, në Prizren është bërë përpjekja e parë e krijimit të shtetit të pavarur shqiptar nga Perandoria Osmane. Në qytetin tonë prej vitit 1878 deri në vitin 1881 ka vepruar qeveria e parë shqiptare në krye me Ymer Prizrenin. Në jubileun e 140 të kësaj ngjarjeje që cilësohet si momenti i lindjes së kombit tonë, Komuna do të organizojë ngjarje të ndryshme kulturore dhe sportive", ka thënë Haskuka. Ai ka deklaruar se prej 10 deri më 15 qershor në Prizren do të përforcojnë artistë nga të gjitha trojet shqiptare, në mënyrë që nëpërmes kësaj ngjarjeje madhore t'i shfaqin vlerat më të çmuara të kombit tonë. "Gjatë këtyre ditëve do të bëhet edhe rivarrimi i eshtrave të prijësit të Lidhjes, Ymer Prizrenit, i cili ka qenë i varrosur në Ulqin. Në muajin qershor (ditën e 12) është edhe Dita e Çlirimit të qytetit tonë dhe me këtë rast ftojmë të gjithë bashkatdhetarët tanë në kryeqytetin historik shqiptar, në Prizren, që t'i bashkëngjiten festës jubilare. Ditët në vazhdim do të publikohet programi nga Këshilli Organizativ", ka thënë Haskuka.

# 'Kadri Zeka' themelon Bordin Këshillëdhënës Industrial

GJILAN, 30 MAJ (ER) - Universiteti Publik "Kadri Zeka" në Gjilan (UKZ) ka mbajtur takim me përfaqësues të institucioneve komunale, të kompanive dhe të bizneseve që veprojnë në rajonin e Anamoravës. Në këtë takim është themeluar Bordi Këshillëdhënës Industrial i Universitetit, ndërsa përfaqësuesit e kompanive e kanë zgjedhur kryetar të Bordit Xhelal Salihun, i cili është përfaqësues i kompanisë "CALABRIA".

Rektori i Universitetit "Kadri Zeka" në Gjilan, Bajram Kosumi, ka falënderuar pjesëmarrësit në takim, të cilët i janë përgjigjur pozitivisht ftesës për të qenë pjesë e këtij Bordi që, sipas tij, është shumë i rëndësishëm për bërjen e politikave zhvillimore të universitetit. "Një nga objektivat më të rëndësishme për Bordin Këshillëdhënës Industrial (BKI) është të kontribuojë në suksesin strategjik të Universitetit Publik 'Kadri Zeka' në Gjilan dhe të programeve studimore të fakulteteve të tij", ka thënë Kosumi, duke shtuar se BKI-ja fokusohet në aspektet e marrëdhënies së mësimit akademik dhe tregut të punës, pra në ndërlidhjen sa më të mirë të programeve studimore me biznesin dhe industrinë.

Rektori Kosumi ka njoftuar se BKI-ja do të trajtojë çështje siç është, përcaktimi i hapave që kërkohen për t'i përmirësuar dhe zgjeruar marrëdhëniet aktuale të programeve studimore të UKZ-së me biznesin dhe industrinë. Sipas rektorit, BKI-ja do ta ndihmojë UKZ-në ta ndërtojë një imazh më të mirë.





# Nis ndërtimi i memorialit në varrezat e dëshmorëve në Malishevë

MALISHEVË, 30 MAJ (ER) - Kanë rifilluar punimet në ndërtimin e memorialit në varrezat e dëshmorëve në Malishevë, përkatësisht të dëshmorëve të Brigadës 122 "Imer Krasniqi". Në ceremoninë e fillimit të këtyre punimeve kanë marrë pjesë kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, kryetari i Degës së OVL të UÇK-së në Malishevë, Metush Kryeziu dhe zyrtarë të tjerë.

Ky memorial ndërtohet në kuadër të rregullimit dhe ndërtimit të memorialit dhe sheshit në këtë hapësirë nga Agjencia për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale. Punimet e filluar kohë më parë ishin ndërprerë për shkak të kërkesës së arsyeshme të organizatave të dala nga lufta për ndërrimin e vendit, brenda hapësirës së varreza të dëshmorëve.

# Klientelizmi partiak, armik i zhvillimit



Valon MURATI

1. Zhvillimi i pluralizmit në Kosovë, sidomos prej vitit 2000 e këtej, përveç shumë karakteristikave të tjera, është përcjellë edhe me klientelizëm. I filluar nga LDK-ja, i perfeksionuar nga PDK-ja e AAK-ja, në këtë valle tani fuqishëm është përfshirë edhe Nisma. Klientelizmi, i përcjellë me nepotizëm, ka arritur që betejën politike të ideve e të programeve ta kthejë në një arenë në të cilin fiton ai që premton më shumë vende pune në administratën shtetërore e në ndërmarrjet publike, ai që premton më shumë tenderë, më shumë certifikata veteranësh e invalidësh të rremë lufte, më shumë shtrim rrugësh e infrastrukturë me e pa prioritet, gjithmonë në këmbim të votës. Ky mentalitet politik i ndërtuar në shoqërinë tonë e ka degraduar rëndë diskursin publik. Sidomos është vështirësuar beteja për koncepte dhe ide politike, qoftë për ato që kanë të bëjnë me të ardhmen politike të vendit (siç janë bisedimet me Serbinë), e po ashtu edhe për ato që kanë të bëjnë me jetën e përditshme, si ekonomia, arsimi, shëndetësia etj. Si të flasësh e çka të flasësh për programet e platformat e fushave të ndryshme, kur pakënaqësive mbi gjendjen politike, socio-ekonomike e të papunësisë enorme nuk u përgjigjen me politika konkrete, me programe e platforma zhvillimore, por me premtime e realizime të paligjshme, nepotiste e klanore për interesa të ngushta!?

Në një situatë kur e tërë energjia e partive politike është përqendruar në marrjen e pushtetit me çdo kusht, kjo ka bërë që edhe premtimet për punësime, për regjistrime në fakultete, për investime e për favore të tjera të kundërligjshme të jenë të pafre. Prandaj, me ardhjen në pushtet, këto parti do të përqendrohen së pari t'i realizojnë premtimet jopublike, e jo ato që i kanë premtuar publikisht në fushatë. Andaj edhe puna e parë pas ardhjes dhe konsolidimit të pushtetit politik është marrja e pushtetit mbi ndërmarrjet publike, mbi universitetet publike e mbi divizionet e prokurimeve të cilat janë përgjegjëse për tenderë, si dhe të realizojnë punësime masive partiake, familjare, regjionale e klanore. Duke mos e pasur kurrë parasysh kriterin profesional, madje, duke i dëmtuar rëndë edhe profesionistët e ndershëm brenda vetë partive politike. Të mos flasim për ata që nuk janë pjesë e strukturave partiake e klanore. Hidhuani një sy bordeve të ndërmarrjeve publike, për të parë se sa poshtë ka rënë katundi! Krejt kjo është përcjellë edhe me ndikimin në rekrutimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve, në mënyrë që të kontrollohet edhe sistemi i drejtësisë, i cili do të duhej të ishte një korrektues i kësaj situate.

2. Duke qenë se problemet socio-ekonomike të qytetarëve janë të mëdha, rruga e sigurimit të vendeve të punës e favoreve të tjera përmes kapjes së administratës, të ndërmarrjeve publike e të tenderëve ishte dhe është shumë më e lehtë sesa rruga e zhvillimit të vendit me politika konkrete në të gjitha fushat. Sigurisht, rezultatet e së parës në planin e realizimit të ndonjë interesi të ngushtë ekonomik duken më të shpejta. Por, në anën tjetër, dëmet për vendin në planin afatgjatë janë të mëdha dhe shkaktojnë një sërë defektesh të cilat duhen vite e vite për t'u riparuar. Një politikë e tillë i ka goditur rëndë tërë sferat e shoqërisë. Mbi të gjitha, e ka rritur në përmasa të mëdha korrupsionin, e ka zvogëluar në minimum sundimin e ligjit dhe e ka vendosur funksionimin e drejtësisë buzë mosefikasitetit të plotë. Por dukuria e klientelizmit në politikë ka shkaktuar dhe po vazhdon të shkaktojë edhe disa defekte të tjera të mëdha shoqërore dhe politike. Ai e ka vështirësuar betejën politike, duke e reduktuar atë nga arena ku duhet të ndeshen idetë, konceptet e programet, në arenë premtimesh për punësime nepotike e dhënie të paligjshme tenderësh, ku punësimi kushtëzohet me angazhimin politik, ku personi që është i punësuar shantazhohet me përjashtim nga puna nëse dëshiron t'i bashkëngjitet një projekti tjetër politik. Në këtë mënyrë, klientelizmi e ka dëmtuar rëndë cilësinë e administratës shtetërore. Para profesionalizmit, kritere bazike janë përkatësia partiake, klanore, familjare, regjionale, e sidomos dëgjueshmëria dhe nënshtrimi. Klientelizmi i ka sjellë buzë falimentimit shumicën e ndërmarrjeve publike; e ka degraduar në tërësi arsimin në Kosovë, duke angazhuar si mësimdhënës bashibozukët e duke e mbyllur derën për punëtorët e dijes dhe shkencës, si dhe duke i hapur auditoriumet për ata që nuk e meritojnë të jenë studentë. Klientelizmi e ka dëmtuar rëndë ekonominë e vendit, duke e bërë konkurrencën të pabarabartë, si dhe duke fuqizuar e favorizuar operatorë ekonomikë që janë të lidhur me partitë, me pushtetin e me klanet kriminale, në dëm të cilësisë së punës, të efikasitetit, të profesionalizmit dhe të kursimit të parasë publike. Klientelizmi e ka goditur ekonominë e vendit edhe duke e bërë të varur nga punësimet në administratën publike dhe në organizata të tjera buxhetore të shtetit, e duke mos u përqendruar për t'i forcuar ndërmarrjet private, të cilat në çdo ekonomi tregu janë bartëse të zhvillimit ekonomik. Fryma e klientelizmit e ka dëmtuar rëndë moralin shoqëror e njerëzor, sepse njerëzit, të detyruar nga ky mentalitet, bëhen anëtarë të partive politike apo i ndërrojnë ato, jo pse besojnë në politikat e tyre, por sepse shpresojnë se do të gjejnë një vend pune, do të marrin ndonjë tender, apo do të realizojnë ndonjë interes ekskluzivisht vetjak. Bartësit e klientelizmit i kanë keqpërdorur në mënyrë kriminale edhe skemat sociale, sidomos për veteranët dhe invalidët e UÇK-së.

3. Në këtë situatë të rëndë shoqërore, ekonomike, politike e morale, njerëzit edhe mund të dëshpërohen e të tërhiqen në vetminë e tyre dhe të angazhohen vetëm për realizimin e interesave të tyre të ligjshme personale, duke i harruar interesat e përgjithshme. Por ne nuk jemi vetëm vetja jonë. Ne jemi edhe pjesë e shoqërisë. Ne kemi edhe fëmijë të cilët po rriten e do të rriten në këtë vend, për lirinë e të cilit sakrifikuam shumë. Nuk kemi sakrifikuar për t'ua lënë në dorë vendin hajnave, kriminelëve e bashibozukëve! Andaj, nuk ka dyshim se rruga e betejës së ideve politike është ajo e duhura, sado që nuk jep rezultate të shpejta, sidomos për shkak të frymës së krijuar klienteliste. Të gjithë njerëzit e ndershëm të këtij vendi, të gjitha forcat progresive, nuk duhet të dorëzohen në këtë betejë të rëndë e të pabarabartë. Nuk duhet të dorëzohen, sepse kjo politikë e mbrapshtë nuk mund të vazhdojë gjatë. Intensiteti i shfaqjes së efekteve të dëmshme të saj është vazhdimisht në rritje. Rasti i fundit është ai i rrezikimit të falimentimit të Telekomit si ndërmarrje publike. Këto falimentime dhe dështimet e tjera mund të sjellin stuhi pakënaqësish të ligjshme të popullit. Me këtë politikë, dështimet në menaxhimin e ekonomisë publike nuk do të kenë të ndalur. Lëvizja për Bashkim do të punojë që për asnjë moment të mos lëkundet nga parimet e veta dhe nga besimi që kjo politikë duhet të luftohet me të gjitha mjetet politike, mediatike e gjyqësore. Do të jemi aleatë me të gjithë ata që do të përpiqen ta ndryshojnë këtë gjendje. Pa këtë ndryshimin nuk ka zhvillim e përparim!

**(Autori është kryetar i Lëvizjes për Bashkim)**

# Përkujtohen dëshmorët Rasim Kiçina dhe Ragip Halilaj




PRISHTINË, 30 MAJ - Në një akademi përkujtimore mbajtur me rastin e 19-vjetorit të rënies janë kujtuar dëshmorët Rasim Kiçina dhe Ragip Halilaj. Në këtë akademi kanë marrë pjesë kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli dhe kryeministri Ramush Haradinaj. Fillimisht Veseli ka theksuar se 19 vjet më herët kanë kaluar sfida të rënda. Ai ka thënë se Zona Operative e Drenicës ka qenë më rezistentja duke bërë një luftë që ka qenë shumë frontale, duke marrë shumë djem dhe vajza. "Sot Kosova është një shtet stabil dhe që ecën në rrugën euroatlantike. Duhet të kemi më shumë besim tek shteti i Kosovës, në mënyrë që ky komb të ecë përpara. Kjo do të jetë rruga jonë. Familjarët duhet të jenë krenarë me bijtë që i kanë pasur, se ata kanë qenë shumë trima. Unë kam pasur nderin të jem krah tyre në luftën për lirinë e Kosovës", ka thënë Veseli.

Ndërsa kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka thënë se është shumë me rëndësi tradita e nderimit për të rënët për liri. "Ndoshta tash nuk është freskia e dhimbjes së humbjes, por që të mos na kthehet dhimbja, duhet t'i nderojmë. Sot ne vërtet po bëjmë një punë të mirë, duke i nderuar dy luftëtarë", ka thënë Haradinaj.

Para se të mbahej kjo akademi, përfaqësuesit e Komunës së Drenasit kanë bërë homazhe te varrezat e dëshmorëve Kiçina dhe Halilaj.

## Sot nis spërkatja kundër rriqrave në Komunën e Rahovecit



RAHOVEC, 30 MAJ - Nën organizim të Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale në Komunën e Rahovecit nga sot (e enjte) do të nisë spërkatja e zonave kundër rriqrave, në kuadër të masave për luftimin dhe parandalimin e Etheve Hemorragjike Krime Kongo (EHKK). Spërkatja e zonave endemike do të vazhdojë sipas planit të hartuar, për spërkatjen, sipas zonave në të cilat ka më shumë raste të regjistruara të thumbimeve nga rriqrat gjatë këtij viti. Nga banorët kërkohet bashkëpunim i mirë, me zyrtarët e kompanisë e cila do ta bëjë spërkatjen e zonave të cilat janë paraparë të spërkaten.

## Përpjekje për marrëveshje tregtare ShBA - BE

PARIS, 30 MAJ - Sekretari amerikan i Tregtisë, Wilbur Ross, tha se mund të arrihet një marrëveshje tregtare mes ShBA-së dhe BE-së edhe nëse Uashingtoni vendos tarifa ndaj importeve evropiane të çelikut dhe aluminit.
Zyrtarët evropianë dhe ata amerikanë po zhvillojnë bisedime të minutës së fundit, dy ditë përpara se presidenti Trump të marrë vendim për tarifat.
Kërcënimi rreth tarifave ka rritur mundësitë për një luftë globale tregtare, që mund ta dëmtojë ekonominë botërore. "Mund të ketë negociata me ose pa vendosjen e tarifave", tha Ross në Organizatën për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim që mbahet në Paris. "Ka shumë tarifa që BE-ja zbaton ndaj nesh, por kjo nuk do të thotë që s'mund të flasim, vetëm për këtë shkak", tha ai.
Administrata e presidentit Trump po sheh mundësinë e vendosjes së kufizimeve për importet e makinave, duke e parë këtë si një çështje që lidhet me sigurinë kombëtare.
Ministri francez i Financave, Bruno Le Maire, tha se BE-ja do t'i mbrojë interesat e saj nëse ShBA-ja do të vazhdojë më tej me kërcënimin e saj për vendosjen e tarifave



# Zaev: Si asnjëherë më parë jemi afër zgjidhjes me Greqinë

Kryeministri Zaev thotë se marrëveshja forcon identitetin maqedonas dhe paprekshmërinë e gjuhës maqedonase, për të cilat edhe janë paraqitur reagimet më të mëdha në opinionin maqedonas, se me lëshimet eventuale këto dy gjëra mund të rrezikohen



Georgi Licovski (EPA-EFE)

SHKUP, 30 MAJ - Kryeministri i Maqedonisë, Zoran Zaev, beson se kontesti me Greqinë për çështjen e emrit është në fazën finale, por se zbatimi i marrëveshjes së mundshme do të kalonte nëpër disa procedura deri në realizimin e plotë të saj, që do t'i hapte rrugën anëtarësimit të plotë të Maqedonisë në NATO dhe Bashkimin Evropian.
Zaevi, në paraqitjen para medieve me rastin e njëvjetorit të formimit të Qeverisë, tha se deri në fund të javës do të bisedojë me kryeministrin grek Aleksis Tsipras për ta konfirmuar kornizën e marrëveshjes për përmbajtjen e së cilës opinioni është i njoftuar nga burime jozyrtare.
Kryeministri thotë se marrëveshja forcon identitetin maqedonas dhe paprekshmërinë e gjuhës maqedonase, për të cilat edhe janë paraqitur reagimet më të mëdha në opinionin maqedonas, se me lëshimet eventuale këto dy gjëra mund të rrezikohen. "Asnjëherë nuk kemi qenë më afër zgjidhjes, ndërsa miqësia mes dy vendeve dhe dy popujve asnjëherë nuk ka qenë më e madhe. Gjuha maqedonase është konfirmuar sikur edhe identiteti ynë. Kjo çështje nuk është e lehtë, por Maqedonisë i duhet lidership që të ecë përpara dhe jo vetëm të thuhen fjalë boshe", tha ai. "Ende nuk kemi një emër konkret. Këtyre ditëve do të bisedoj me kryeministrin grek, Tsipras, e kjo mund të ndodhë deri të premten për ta vërtetuar kornizën e arritur", ka deklaruar kryeministri Zaev, pa saktësuar nëse si propozim i fundit për emrin është "Republika Maqedonia e Veriut", por në anën tjetër ka konfirmuar se zgjidhja përfundimtare duhet të vërtetohet në referendum, ndërsa paraprakisht Kuvendi i Maqedonisë duhet t'i japë mbështetje marrëveshjes me një shumicë të thjeshtë të votave, por që nuk do ta nënkuptonte zgjidhjen përfundimtare të problemit. "Ratifikimi duhet të bëhet para referendumit që të mund Greqia t'i dërgojë letër NATO-s për ta marrë ftesën për anëtarësim, ratifikimi i marrëveshjes nënkupton mbështetje për atë që kanë arritur dy qeveritë dhe unë besoj se do të gjejë një mbështetje të madhe në Kuvend, edhe nga opozita. Por, të gjithë duhet ta dinë se fjala e fundit do të thuhet në referendum andaj të gjithë qëndrojmë pas këtij detyrimi. Fundi i shtatorit apo fillimi i tetorit mendoj se do të ishte koha e përshtatshme, por për këtë duhet të merremi vesh", ka deklaruar Zaevi.
Duke komentuar kritikat e presidentit, Gjorge Ivanov për mungesë të transparencës, Zaevi tha se kreu i shtetit gjatë ditës do të njoftohet me detajet e bisedimeve nga shefi i diplomacisë, Nikolla Dimitrov, i cili të mërkurën është kthyer nga vizita në Bruksel.
Edhe kryeministri i Greqisë, Aleksis Tsipras, ka theksuar nevojën e vazhdimit të bisedimeve për arritjen e një zgjidhjeje të pranueshme pavarësisht prej reagimeve në skenën politike.
Tsipras, siç transmetojnë mediet, ka deklaruar se "perspektiva e zgjidhjes së problemit qëndron në vendimet e vështira, por të domosdoshme me ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë". "Në këto negociata ne vazhdojmë të udhëhiqemi me ndjenjën e përgjegjësisë dhe patriotizmit. Por, edhe me vendosmërinë dhe besimin për gjetjen e zgjidhjes... këtë ne tentojmë ta bëjmë, duke punuar për zgjidhje, pasi besojmë se mund të kthejmë pozicionin udhëheqës të vendit në Ballkan, kjo do të kishte pasoja pozitive jo vetëm në planin gjeopolitik, por edhe në sferën e ekonomisë duke krijuar një dinamikë të re për zhvillimin e rajonit, të Ballkanit, një perspektivë të re të bashkëpunimit mes shteteve", ka deklaruar Tsiprasi në një manifestim afaristësh në Athinë.
Situata me fatin e bisedimeve pritet të qartësohet pas publikimit të detajeve të marrëveshjes që ende po mbahet në fshehtësi, e për të cilën pritet të këtë një qëndrim të qartë opozita maqedonase e cila deri më tani ka kundërshtuar çdo zgjidhje që parasheh ndryshimin e kushtetutës dhe heqje dorë nga identiteti dhe gjuha maqedonase.

## Izraeli vazhdon sulmet ajrore në Rripin e Gazës

TEL-AVIV, 30 MAJ - Ushtria izraelite tha të mërkurën se avionët dhe helikopterët e saj luftarakë kryen sulme të reja ajrore gjatë natës kundër pozicioneve të Hamasit në Rripin e Gazës, ndërsa sistemi i mbrojtjes nga raketat ka diktuar dhe shkatërruar predhat që kishin si objektiv goditjen e zonave izraelite pranë kufirit me enklavat palestineze.
Forcat Mbrojtëse të Izraelit thanë se sulmet ajrore kishin në shënjestër objektet e prodhimit të raketave dhe municioneve, si dhe baza ushtarake dhe ato të trajnimit.
Të dyja palët shkëmbyen të shtëna me mortaja dhe sulme ajrore të martën, në shpërthimin më të madh të dhunës që nga lufta 50-ditore e vitit 2014. "Bregu Perëndimor, Jerusalemi, veçanërisht Rripi i Gazës, kanë kaluar ditë të vështira. Forcat pushtuese izraelite filluan sot një agresion të ashpër në Rripin e Gazës me raketa dhe avionë. Kjo tregon se pushtuesi nuk dëshiron paqe, ndërsa ne kërkojmë paqe", tha Mahmoud Abbas, president i palestinezëve.
Forcat izraelite kanë vrarë të paktën 115 palestinezë që nga fundi i marsit, duke tërhequr kritika për përdorimin e forcës. Izraeli ka fajësuar grupin militant Hamas për nxitje të dhunës dhe thotë se ka vepruar për ta mbrojtur kufirin.



Reuters

Reagim i KMDLNj-së

# ZONAT E MBROJTURA DHE TË DREJTAT E PAMBROJTURA



Ditët e fundit ishin dy ngjarje që shkaktuan reagime të vendorëve dhe të ndërkombëtarëve dhe të cilat u trajtuan dhe interpretuan nga këndvështrime thuaja diametralisht të kundërta. Rasti i parë ishte vazhdimi i rregullimit të rrugës ekzistuese që e lidhë Pejën me Malin e Zi, kurse rasti i dytë ishte reagimi i banorëve të fshatit Potërq të Klinës gjatë vizitës së serbëve të zhvendosur nga pronat e tyre dhe të kishës, të shndërruara në rrënoja. Ndërprerjen e punëve në rregullimin e rrugës ekzistuese e kërkoi, në emër të Manastirit në Deçan, at Sava Janjiq, kurse po të njëjtën gjë e kërkuan OSBE-ja dhe Ambasada Amerikane në Prishtinë. Arsyetimi i kërkesës për ndërprerje të punimeve ishte se po cenohet zona e mbrojtur, ku gjendet edhe Manastiri i Deçanit sikur edhe rruga në të cilën po punohet. Ndërkaq, pala e Kosovës deklaron se rruga nuk është në perimetrin e zonës së mbrojtur dhe rrjedhimisht kërkesa e Sava Janjiqit dhe Kishës ortodokse serbe është e pabazuar. Me Pakon e Ahtisarit janë përcaktuar zonat e mbrojtura dhe në bazë të kësaj institucionet e Kosovës janë pajtuar t'i respektojnë këto zona, thuaja si zona të pavarura sikur që janë përcaktuar veprimet e lejuara dhe të palejuara, nga të dyja palët.

Manastiri i Deçanit ka pasur një kontest pronësor me Komunën e Deçanit dhe Gjykata Kushtetuese ia ka njohur këtij manastiri të drejtën mbi pronat e kontestuara. Me kërkesë të Kishës ortodokse serbe dhe Manastirit të Deçanit, banorëve të kësaj ane u është ndaluar çdo ndërtim kur këta e kanë vlerësuar se paraqet pengesë apo shqetësim për murgjit dhe personelin e këtij manastiri dhe për këtë gjithmonë e kanë pasur përkrahjen e ndërkombëtarëve.

Manastiri i Deçanit, para dhe sidomos gjatë luftës, më së paku ka qenë vatër shpirtërore për besimtarët ortodoksë, por ka qenë bazë paramilitare, policore dhe ushtarake ku është strehuar armatimi dhe, sidomos gjatë luftës, dyshohet se aty janë mbajtur dhe keqtrajtuar shqiptarët. Menjëherë pas përfundimit të luftës, në një informatë me këtë përmbajtje të KMDLNj-së pati reaguar pikërisht Sava Janjiq, duke e denoncuar KMDLNj-në te OSBE-ja, e cila asnjëherë nuk ka pasur qëndrim neutral dhe të drejtë pas së cilës, OSBE-ja ka kërkuar që KMDLNj-ja ta përgënjeshtrojë publikisht këtë informatë duke i kërkuar falje publike Sava Janjiqit ose, në të kundërtën, do të përballet me një ballafaqim para gjykatës. KMDLNj-ja as nuk i ka kërkuar falje publike Sava Janjiqit, as e ka përgënjeshtruar informatën, duke pritur të përballet në gjykatë, por se rastin e ka mbyllur ajo që e pati hapur, OSBE-ja. KMDLNj në atë kohë Sava Janjiqin e ka konsideruar paramilitar kishtar që ka kontribuar për eskalimin e dhunës ndaj shqiptarëve sikur që edhe sot e konsideron si penguesin më të madh të normalizimit të marrëdhënieve midis Manastirit të Deçanit dhe banorëve të kësaj ane, duke ua kufizuar lirinë e lëvizjes dhe duke denoncuar banorët se, kinse, po e pengojnë atë dhe personelin e manastirit në punët e tyre. Edhe sot Sava Janjiq, nën petkun e priftit "të moderuar" dhe bariut shpirtërorë, në mënyrë strikte po e zbaton politikën e Serbisë në Kosovë, duke e shndërruar Manastirin e Deçanit në një oazë ekstraterritoriale. Për rastin konkret, KMDLNj kërkon të sqarohet nëse rruga ekzistuese ku kanë filluar punimet është në kuadër të zonës së mbrojtur apo nuk është. Nëse është pjesë e zonës së mbrojtur atëherë ligjërisht Kisha ortodokse serbe dhe Sava Janjiq, OSBE dhe Ambasada Amerikane kanë të drejtë në kërkesat e tyre për ndërprerjen e punimeve ndërsa, nëse kjo rrugë është vetëm 1 mm jashtë zonës së mbrojtur, atëherë punimet duhet të vazhdojnë. Nga aspekti i të drejtave të njeriut, çdo pengim i lirisë së lëvizjes, për të gjithë dhe pa bërë dallime, është shkelje flagrante e këtyre të drejtave si dhe konsiderohet e papranueshme. Në disa raste, sidomos sa i përket Manastirit të Deçanit, të drejtat e njeriut janë më të rëndësishme se një marrëveshje politike apo Pako, e kujtdo qoftë ajo e që dhunshëm është bërë pjesë e Kushtetutës. Banorët e kësaj ane kanë nevojë dhe të drejtë t'i shfrytëzojnë ato rrugë dhe hapësira për të lëvizur dhe punuar, pa i penguar të tjerët, në rastin konkret personelin e Manastirit të Deçanit sikur që Manastiri i Deçanit nuk mund të ekzistojë i izoluar, pa përkrahjen e banorëve të kësaj ane apo duke punuar kundër interesave të këtyre banorëve. Pikërisht në këtë rast duhet fleksibilitet dhe tolerancë. Ndërkaq, banorët e kësaj ane nuk mund të kërkojnë përgjegjësi nga Manastiri i Deçanit, OSBE-ja apo Ambasada Amerikane për këto zona të mbrojtura, por duhet të kërkojnë përgjegjësi nga politikanët e papërgjegjshëm dhe të pandërgjegjshëm kosovarë që i kanë pranuar këto zona si të tilla për ta lënë një problem që gjithmonë mund të shpërthejë në dhunë, sidomos kur i kemi dy palë jobashkëpunuese dhe që nuk lëvizin nga pozicionet që i mbajnë. Pastaj, e kemi një vendim të Gjykatës Kushtetuese që duhet të respektohet aq më parë që nuk ka pasur dhe nuk ka mundësi tjetër ankimimi.

Rasti i dytë është reagimi i banorëve të fshatit Potërq të Klinës që e kundërshtuan vizitën e ish-bashkëfshatarëve të tyre serbë në pronat dhe kishën e shkatërruar, me pretekstin se ata kanë kryer krime duke vrarë 15 shqiptarë të këtij fshati. Pas kësaj proteste banorët që protestuan hynë në një përleshje krejtësisht të panevojshme me policët e Kosovës. KMDLNj-ja ua përkujton të gjithëve se liria e lëvizjes, si e drejtë elementare e njeriut, posedimi dhe shfrytëzimi i pronës private, si e drejtë e patjetërsueshme, është e drejtë e njeriut si dhe të drejtat fetare janë të drejta të garantuara të njeriut të mbrojtura me të gjitha dokumentet ndërkombëtare dhe kombëtare për të drejtat e njeriut. Këto të drejta përbëjnë universalitetin e këtyre të drejtave dhe, si të tilla, janë të pandashme. Në këtë kontekst, të gjithë personat e zhvendosur, pa dallime etnike etj. dhe që, për shkaqe të ndryshme janë detyruar t'i braktisin pronat e veta, kanë të drejtë të kthehen në këto prona, t'i shfrytëzojnë papengueshëm ato dhe kthimi i tyre nuk mund të kushtëzohet me asgjë. Ata për të cilët ka prova se kanë bërë krime lufte apo se i kanë ndihmuar këto krime, duhet të arrestohen dhe të përballen me drejtësinë por, ky fakt, nuk duhet dhe nuk mund të përdoret si arsyetim që të mos lejohet kthimi i personave të zhvendosur.

Zhvillimet në fshatin Potërq të Klinës KMDLNj-ja i konsideron krejtësisht të panevojshme dhe përpjekja për ta penguar kthimin e personave të zhvendosur është i papranueshëm dhe nuk mund të arsyetohet me asnjë pretekst. KMDLNj-ja përkrah të drejtën e kthimit të të gjithë personave të zhvendosur duke mos bërë dallime në baza etnike, gjinore, politike, sociale etj., si e drejtë elementare e njeriut dhe e patjetërsueshme. E drejta për kthim të personave të zhvendosur dhe e shfrytëzimit sipas vullnetit të pronave të veta nuk mund të bëhet në mënyrë selektive ku insistohet që serbët e zhvendosur duhet të kthehen, kurse shqiptarëve u mohohet kjo e drejtë për kthim në veri të Kosovës. Ky respektim dhe zbatim i universalitetit të të drejtave të njeriut është një ndër kushtet kryesore, në mos kryesori për normalizimin e marrëdhënieve ndëretnike në Kosovë.

# KATEDRALË LETRE: ARTI RUEN KUJTESËN

## Poezia si Zeigen Heideggerian



HALIL MATOSHI

Monumentalen në poezinë "Nana i bani rangët e shpisë e ra me fjetë" e kam krijue pas vdekjes së nanës si tip psiko-social, në një mërzi të thellë, e cila, sipas Giacomo Leopardit që e citon Giorgio Agamben (Çelnaja), asht "dëshira për lumtuni, e lanun, në njëfarë mënyre, në gjendje të kullueme" sepse nana asht aty, tu-bamja [tuebamësia] e saj asht fërkem (gjurmë), kujtesë (jo thjesht si akt dhe aktim i shfaqun, por ashtu qysh më kujtohet, e shpejtë si drugëz, si drita e vetimës, pra ngjarje, si personazh konceptual, monument; dhe kjo asht një lumtuni së cilës i asht eliminue llumi, lumtuni e kullueme.

Tanë jetën kam luftue kundra shurdhnisë njerzore (jo asaj klinike) kur nuk dojmë apo nuk dimë me e ndëgjue zanin e natyrës, qinda-mija tinguj, tone e nuanca, vaje e gulçima, gurgullima e hungurima, zukatje yjesh e bletësh, ulurimëza bubrrecash e gjamëza fluturash..., ato nuk janë tinguj të presionumë nga ajri, që na i zhbirojnë veshët, ato nuk thuhen me gjuhën e zakonshme, nuk ndihen me veshin si aparat i të ndëgjuemit të përditshëm! Kam vu vesh dhe kam ngue me orë të tana këta zana në natyrë, kam vrejtë me ditë të tana sendet e pagoja, rrjedhën e prronit, piklat e shiut, kam vështrue yjet dhe dëgjue kam shkëputjet e tyne nga qielli, jam përpjekë me u dhanë gjuhë gjanave (objekteve) e fenomeneve që për nga natyra janë të nemituna. Gjanat e nemituna janë të mundshme (Deleuze & Guattari) dhe bahen të nimete ('të njëmendta'; që për mue e përfshinë zeigen-in heideggerian, që dmth. jo me tregue por me thanë qenësoren) vetëm gjatë zbulesës në art. Sipas Deleuzes & Guattarit pasoja e natyrshme e këtij përshkrimi asht se arti jo vetëm që nuk asht shprehje e njerëzores, por madje s'ka të bajë fare me njerëzoren, asht gjaja ma e huej ndaj njerëzores. Alain Badiouja tue folë në seminar për librin e Deleuzes & Guattarit spikat se krijimi nga njeriu i jonjerëzores [mosnjerëzores] nëpërmjet artit përban shenjën e qartë të epërsisë së artit, në raport me krijimtaritë tjera (Alain Badiou).

Këta dy autorë mbrojnë qëndrimin se arti ruen, madje në botë arti asht e vetmja gja që ruhet. (Deleuze & Guattari, po aty, fq. 203; "Ai run dhe ruhet në vetvete (quid juris), edhe pse nuk jeton ma gjatë se suportet dhe materialet e veta (quid facti), gur, telajo, ngjyrë kimike etj.)

Sipas tyne, ajo çka ruhet, sendi ose vepra e artit, asht një bllok ndijimesh, domethanë një kompozim perceptesh dhe afektesh. Gianni Vattimoja tue iu referue Heideggerit "ajo që mbetet e krijojnë poetët" sipas Holderlinit, thotë, "ajo që mbetet e krijojnë poetët: jo gjithaq si ajo që stërzgjatet në kohë ("ruhet"), jo ajo që ruen dhe ruhet sipas Deleuzes & Guattarit, por mbetet, si "ajo që mbetet": gjurmë, kujtesë, monument. Edhe Gianni Vattimoja kur flet për krijimin (ardhjen, në kuptimin e ardhjes së bukës) e fjalës poetike mendon se me operacionin poetik mëtohet të mbërrihet ajo gjyserrësina, Lichtung, nocion heideggerian që lidh zdritjen me terratisjen, në të cilën e vërteta shfaqet jo ma në formë të qartësisë metafizike, e cila me veprimin eroziv që koha ushtron mbi veprën, atë e shndërron në monument (Vattimo).

Për Norman O. Brownin, krijimi i monumenteve madhështore si piramidat dhe rrokaqiejt tregojnë se sa asht edhe veprimtaria "ekonomike" po ashtu ikje nga vdekja. Monumentalen në poezinë "Nana i bani rangët e shpisë e ra me fjetë" e kam krijue pas vdekjes së nanës si tip psiko-social, në një mërzi të thellë, e cila sipas Giacomo Leopardit që e citon Giorgio Agamben, asht "dëshira për lumtuni, e lanun, në njëfarë mënyre, në gjendje të kullueme" sepse nana asht aty, tu-bamja [tuebamësia] e saj asht fërkem (gjurmë), kujtesë (jo thjesht si akt dhe aktim i shfaqun, por ashtu qysh më kujtohet, e shpejtë si drugëz, si drita e vetimës, pra ngjarje, si personazh konceptual, monument; dhe kjo asht një lumtuni së cilës i asht eliminue llumi, lumtuni e kullueme. Pra Nana asht O.K.!

Alain Badiouja për konceptin e Deleuzes & Guattarit mbi artin shkruen se këta dy autorë artin e cilësojnë si krijimtari monumentesh. "Çdo vepër arti asht një monument", thonë ata. Sipas Badiousë një pozicion i tillë sjell më veti një varg të tanë metaforik, i cili shërben për me e shprehë idenë se arti ka të bajë me visoret dhe me personazhet (dmth. percepte dhe afekte). Por, sipas tij, metafora e vërtetë dhe ma e përgjithshme ka me qenë ajo e monumentit. Poezia "Nana i bani rangët e shpisë e ra me fjetë" asht vendosë në kohë të kondensume, (veprimi kryhet prej të bamit nanë, e deri në vdekje) dhe në një hapësirë metafizike të paanë, ajo 'skulpturohet' në atë mënyrë sa që kufini i marrëdhanies me të birin zhduket; autori fëmijë i saj si pamës dhe në-bamje [në-tëbamë] e kundron artin e tubamit [tuebamësisë] të nanës (rangët e shpisë) e jo vet aktin e rangëve, si përvojë dhe kujtesë - kështu lind poezia dhe nana e ban atë shkëputjen brilante nga jeta në vepër arti dhe tashma i ngjan secilës nanë - si personazh konceptual - tue u ba "nanë në të bamë e sipër, pra ngjarje pafundësisht e shkume" e cila si percept e ban jetën e vet si një visore para njeriut, në mungesë të njeriut - në ndër-kohë (Deleuze & Guattari), që rri në kambë, vetvetiu mes dy çasteve: rangëve dhe qetimit, ose lëvizjes së ndalun. Dhe kjo "histori me nanë" mund të thuhet vetëm në gegnisht!

A do të ngjallte emocion po të thuhej: 'Nëna i bëri punët e shtëpisë dhe ra për të fjetur'? Kësaj pyetje ia la me iu përgjegj vet lexuesi.

Për me iu përgjegj pyetjes se si mund të bash një çast të botës jetëgjatë ose ta bash atë çast të ekzistojë në vetvete, Deleuzeja & Guattari citojnë Virginia Woolfin, e cila jep një përgjegje që vlen për muzikën dhe pikturën, po aq sa për shkrimin: "Të ngihet çdo atom", "Të eliminohet çdo llum, vdekje dhe kotësi", Deleuze & Guattari.)

Deleuzeja & Guattari për monumentalen e marrin shembullin e Claude Simonit që përshkruen dashuninë e naltë pasive të grues-tokë, ai skulpturon një afekt deltine prej ku mundet me u shprehë: "asht nana jeme". Badiouja kësaj qasjeje i ban dy vërejtje. E para, sipas tij, filozofia i referohet skulpturës Deleuze & Guattari) si art sipëror dhe e dyta, asht mësymja e filozofisë nga arti, sepse arti asht "bllok perceptesh dhe afektesh", ose "bllok ndijimesh", prej ku buron edhe funksioni paradigmatik që i njihet skulpturës.

Këta dy autorë këtë cilësi ia atribuojnë skulpturës.

Tek poezia "Bukuria e trishtimit" për mue Arusha (me a të madhe) e kaftë e Artës - ajo lodra e ditëlindjes - që rri e nemitun nalt në dhomë, derisa na jemi strukë në podrum, gjithashtu flet - me mospraninë! Por asht qenie-nëbotë, [meqenësi] jonjerëzore, e krijume me fuqi njerëzore - pra asht monument.

Era që fryn dhe bari që rritet pas shiut, gjithashtu flasin - por gjuha asht e vorfun për me shenjëzue atë që thonë. Lulet, gjethet, drujtë, gurët dhe ajri si "qenie të arratisjes" deleuzeiane - dhe posaçërisht ajri, flasin.

Deleuzeja & Guattari tue e marrë si shembull Marcel Proustin, i cili, me çdo gja të fundme, formon një qenie ndijimi që nuk pushon me qenë, por tue u arratisë nëpër planin e kompozimit të Qenies. Autorët në shembullin XIII, shkrujnë se muzika ndoshta mishnon ma tepër fuqi sesa artet tjera. "Por, kompozitet e ndijimeve, blloqet tingullore, janë po aq parete ose forma kundrimi që për secilin rast duhet të puthiten për me siguru njëfarë mbylljeje. Rastet ma të thjeshta janë ai i aries melodike që asht një refren monofonik, motivi që asht tashmë polifonik, element i një melodie që ndërhyn në zhvillimin e një melodie tjetër tue realizu kontrapunktin, tema si objekt modifikimi harmonik përmes linjave melodike" (Deleuze & Guattari.)

A nuk janë qenie ndijimi tue u arratisë, pra arie, ajri që këndon i autorit të këtij shkrimi dhe ora që ec pa pra, pa ndërrue vend e Mjedës?

"Qëllimi i poezisë asht përvojë, në thelb e pathanshme: e bukura vepron me diçka që asht e pathanshme, e papërshkrushme, e parrëfyshme... Por nëse dojmë me ba të njajtin veprim me ndihmën e gjanave të thanshme, përmes gjuhës apo nëse ndijmë se përdorimi i gjuhës prodhon të njëjtën gja, do me thanë se tashti gjuha përdoret për atë që të krijojë të nemitunën, që gjuha shpreh nemitjen" (Zigmund Freud).

Poezia asht pra ringjallje, besim dhe reinkarnacion, fe e be - se jemi, se kemi, pra asht kamje, adresë pra shpi.

Poezia, ç' asht pra kjo, pos besim, kujtesë, bamje, lëvizje pa lujtë vendit, pavdekësi...

*(Ky shkrim është një variant i shkurtër i një teksti të gjatë)*

**(Marrë nga numri i dytë i revistës për kulturë, gjuhë dhe media, "Akademia")**

Halil Matoshi

## Sa le't ish me e bajt nanën mbi supe...

ia kam pa tmerrin tek i randonte n'çerpikë
kur shihte në TV gra të thyeme moshe
të ndjekuna armiku
që dikush i tërhiqte zvarrë mbi ndoj thes të dhintë apo ngrykë
si fëmijë të ngrim' acarri,
grumbulluq në ndoj karro me rrotë të shfryme...
të mos flas kur ndjente vajtime mbi fëmijë e burra të grimë thike

nana s'bante as dh'et hapa pa u mbush' frymë

në duart e policisë serbe kur rashë
dhe u bana gati për pushkatim
çuditnisht qëndroi pa b'za
si ni staue pej dheu e shtangun
seciles arkeologët ia marrin masat
dhe përmasat ia hamendin
moshën pulsin rrezistencën ndaj përplasjeve
dhe tundimet e tokës nanë
dhe munohen me ia gjet fillin e gjallesës
dhe me ia konstruktue ni vdekje tepër tragjike dhe me ia shkaktue ni dhimtë të madhe
sa vrasja e djalit
ni tmerr të pakufishem sa historia botnore
me ia thur pastaj ni trill letrar
dhe me e ba ni dramë gjithkohësie

nga e thjeshta e heshtun nga ni nanë

e kam shikue beftë
dhe sall sytë i kanë leviz
sa për t'ma ba me dije se e kam lanë të gjallë
prit'm nanë kam dashtë me i thanë
dhe zani m'ka tradhtue...

e ndiej edhe tashti ajo m' thosh'
nuk kam me dekë pa ardh nga syrgjyni bir
jam qindpërqind i sigurt se ka dashtë më më thanë me dekë
nuk kam po ia ka vnue dorën gojës
mos ban sakrilegj
mos me i dal ofshamë

ajo u ba ni nanë fantastike dhe më priti
me ma pa ballin pa gjak duert
me m'i shtrëngue pa zingjirë
u bana dhe unë ni djal durimtar dhe ia prita dekën e bardhë
hijeshinë e qefinit
pashë sa le't asht me e bajt nanën në supe
pesë djel t'rritun... tek ndërrohet me bijtë e tyne
(aq e le'të ish nana dhe të duket sikur të dyja kambët po t'sharrojnë në dhe - ndoshta asht krejt njajt sikur ajo ka bajt fëmijë n'bark, veçse ti tashti ke mërzi ajo atohera asht kanë e gzueme, ajo po bante jetën!?)

ma pa lirinë
ia pashë dekën...

*

në ni agim pranveruer maj men'
nanën t'veshun solemnisht
ajo po knon ajo nuk flen...

masanej shpejt, le't pa za mendonte
gjithçka ra n'vend të vet si në ni skenë ku luhet balet
i bani rangt e sh'pisë nana
e ra me fjetë...
n'vjeshtën e vonë

në fund të fundit fluturoi naltë
si flutur veshun me t'bardha stine
Nana e Lumja

# SI DISKUTOHET NJË LIBËR PA E LEXUAR

## Titulli në origjinal: Noah's Ark, Tourist Class



**EPHRAIM KISHON**
Shkrimtari izraelit Ephraim Kishon është lindur në Budapest më 23. 8. 1924. Emri i tij i lindjes ishte Fernc Hofmann. Ka vdekur me 29. 1. 2005 në Meistersrçte, Zvicër. Ishte një saterik izraelit, me prejardhje hungareze. Në letërsi botërore vlerësohet si njëri nga satirikët më të mirë të shekullit 20-të. Në gjuhë gjermane ka të botuar 42 libra, që përmbajnë përmbledhje të satirave, 3 romane, 12 drama. Ka marrë dhjetëra çmime letrare nga Institucione të ndryshme botërore.

Etërit tanë, të cilët shpikën shkrimin hebraik para disa mijëvjeçarëve, duhet të kenë qenë majtistë, sepse shkruanin nga djathta në të majtë. Përveç kësaj, ata duhet të jenë përcaktuar që shkrimi i librave të shenjta të mos mund të lexohej nga masat. Prandaj, si në stenografi, ata eliminuan të gjitha zanoret. Dhe kjo është arsyeja pse në hebraisht është më lehtë të shkruash sesa të lexosh. Nuk është befasuese, që shkrimtarët hebraikë janë vazhdimisht nën ethe për gjetjen e lexuesve. Numri mesatar i lexuesve të tyre është tre: botuesi, korrektuesi dhe printuesi. Si lexues të katërt, ata më duan mua.

***

Rasti me Tola'at Shanin më merakoste. Jo, vërtet nuk ishte mirësjellje nga ana ime. Para nja gjashtë muajsh ai ma dërgoi librin e tij të ri. Sapo e mora, e vura mbi tryezë apo diku tjetër dhe atje, kudo që të jetë tashmë, patjetër duhet ta kenë mbuluar rrjetat e merimangave.
Fillimisht ia dilja të justifikohesha me anë të arsyetimeve të zakonshme: "Po, e kam marrë! - i thosha kalimthi, kur e shihja Tola'at Shani nga larg. - Sapo të kem pak kohë të lirë do ta lexoj!"
Dhe autori i ri premtues më buzëqeshte me mirënjohje.
Një ditë, papritmas, e pashë duke ardhur rrëmbimthi drejt meje. E sqarova se isha në mes të leximit dhe se për të do të flisnim pak më vonë, kur ta mbaroja të gjithin.
Shumë shpejt pas kësaj dite ndodhi një rastësi tjetër e turpshme. Tola'at Shani hyri në kafene dhe shikimi i tij, së pari, u drejtua nga unë, në momentin kur u ngrita dhe isha duke dalë. Mbaj mend shumë mirë, që pikërisht atë ditë pata vendosur ta shfletoja me kujdes librin. Nëse nuk gaboj, pata shtrirë dorën drejt librit. Por pikërisht atë çast pati cingëruar telefoni, pastaj zilja e derës dhe ndodhi edhe diçka tjetër, që dora ime nuk e arriti dot librin. Dhe kështu, libri mbeti sërish i paprekur.
Pak ditë më parë, kur isha duke pritur në radhë për një biletë filmi, papritmas dikush më kapi për krahu. Ishte Tola'at Shani. Kësaj radhe nuk kisha si t'i ikja.
- E keni lexuar librin? - më pyeti ai.
Unë pohova disa herë duke tundur kokën dhe me një pamje serioze në fytyrë.
- Ne duhet të flasim për këtë më gjerësisht. Unë kam shumë për të thënë. Por këtu, duke pritur në radhë...
Unë nuk e kisha mbaruar ende fjalinë, kur në sportel u vendos tabela me mbishkrimin "biletat mbaruan". Fati im qe vulosur. Vetëm një shqiponjë që shfaqej papritur në qiell e që mund të më rrëmbente në kthetrat e saj mund të më shpëtonte. Por, për fat të keq, në Tel Aviv nuk ka shqiponja. Përkundrazi, ka shumë kafene... Kaq shumë, saqë në çdonjërën prej tyre do të gjendej një tavolinë e lirë për dy veta. Tola'at Shani, i cili ende nuk ma kishte lëshuar krahun, gjeti atypari një tavolinë për dy veta. Pas pak çastesh u gjendëm të dy përballë njëri-tjetrit.
- Kështu, pra, - ia nisi Tola'at Shani, - ju donit të flisnit me mua për librin tim.
- Po, - u përgjigja. - Më vjen mirë që, më në fund, ju takova.
Ajo situatë ku u katandisa më kujtonte disi pikën kulmore dramatike të disa filmave të Wild West-it, kur sherifi dhe arroganti përplaseshin në rrugën kryesore, të braktisur nga njerëzit, dhe ballafaqimi përfundimtar nuk mund të shmangej. Edhe rruga "Dizengoff" papritmas m'u duk aq e braktisur. Nuk mbaj mend të më jetë dukur ndonjëherë aq e braktisur. Asnjë fytyrë të vetme e të njohur nuk arrija ta shquaja.
Gjithë mëdyshje u përpoqa ta rikujtoja librin, por në kujtesën time virtuale u shfaq vetëm zarfi ngjyrë kafe, brenda të cilit gjendej libri, por që nuk e kisha hapur ende. Të paktën të dija se çfarë libri ishte dhe çfarë tematike kishte. Të dija nëse ishte një roman, një përmbledhje me tregime, një tufë poezish, një dramë, një përmbledhje esesh. As këtë nuk e dija.
Heshtja e plumbit kërcënoi të më ngufaste. Unë duhej të thosha diçka patjetër.
- Duhet t'ju them vetëm diçka, - i thashë. - Ju keni bërë një punë të jashtëzakonshme në këtë libër.
- Tre vjet, - pohoi Tola'at Shani. - Por temën kam shumë vite që e kam në mendje.
- Vetëkuptohej menjëherë kjo. Është një punë me vlerë.
Heshtje. Heshtje varri! Pa shpëtim.
As për të qeshur nuk po më vinte më.
- Ju lutem, tani më thoni mendimin tuaj për librin, - kërkoi të dinte autori i ri premtues, me një zë serioz, që mbante peshën e pritjes së vlerësimit.
- Unë jam shumë i impresionuar!
- Jeni impresionuar nga përmbajtja e librit?!
Në çastin e fundit më ra diçka në mendje, që të shpëtoja nga kurthi. Tola'at Shani më vështronte me aq vëmendje, sa po më hante me sy. Nëse do t'i përgjigjesha "Po, jam impresionuar nga libri juaj", ai do ta kuptonte menjëherë se unë nuk e kisha lexuar librin.
- Dua të jem shumë i hapur me ju, - i thashë. - Fillimi nuk m'u duk gjithaq impresionues.
- Edhe juve? - psherëtiu Tola'at Shani i hutuar. - Unë nuk e mendoja kështu. Një shkrimtar i njohur si ju duhet ta dinte se çdo libër ka nevojë për një ekspoze.
- Ekspoze! - thashë në mënyrë paksa të pakontrolluar. - Pyetja është nëse një libër të përthithë menjëherë ose jo.
Tola'at Shani uli kokën dhe dukej aq i mërzitur, saqë u ndjeva keq për këtë. Por pse ai shkruan ekspoze të tilla të mërzitshme?
- Më vonë tematika merr hovin e saj, - e ngushëllova. - Personazhet i keni shtjelluar shumë mirë. Dhe historia ka atmosferë, ka ritëm, - thashë, duke u paraqitur sikur ato që thosha, ishin të vërteta.
- A jeni dakord edhe ju, se unë duhet ta shkurtoj gjysmën e pjesëve përshkruese të librit?
- Nëse do ta kishit bërë këtë, do të ishte një bestseller.
- Mund të bëhet, - tha Tola'at Shani krejt ftohtë, - por për mua ishte më e rëndësishme të rrëfeja saktësisht pse Borisi u bashkua me rebelët kryengritës.
Borisi!!! Ja ku më doli Borisi!
- Borisi është një karakter që nuk harrohet shpejt, - u ndjeva i detyruar të shtoja. - Vërehet që e gjithë dashuria jote i kushtohet atij.
Tola'at Shani më pa me sy të zgurdulluar.
- Dashuri? E dua unë Borisin? Këtë derr? Kriminel? Unë mendoj se ai është karakteri më shpifarak që kam krijuar ndonjëherë!
- Ju vetëm e besoni këtë, - e udhëzova atë. - Më lejoni t'ju them se ju, pandërgjegjshëm, identifikoheni me të.
Tola'at Shani u zbeh.
- Ajo që thoni ju më vret si plumbi, - murmuriti ai, pa bërë ndonjë lëvizje. - Kur fillova ta shkruaja librin, e urreja Borisin. Për këtë jam i sigurt. Por, pastaj, kur ai u bë pjesë në grindjen midis Pjetrit dhe atasheut detar dhe kur nuk i tregonte nënës së vet për përdhunimin që i kishte bërë Abigailit... Besoj se ju kujtohet?
- Edhe çfarë nëse më kujtohet! Ai nuk i rrëfeu nënës së tij asgjë...
- E saktë! Prandaj e pyeta veten: "A është Borisi një person më i vlefshëm sesa një zoolog, me të gjitha prapështitë dhe mangësitë e tij?
- Ne të gjithë jemi njerëz, - i thashë lirshëm. - Disa janë të tillë, disa të tjerë janë tjetër lloj por, në thelb, të gjithë jemi të njëjtë.
- Pikërisht kjo është ajo që desha të thosha.
- Tashmë po mendoj, se duhet ta kem lexuar librin? Si të them, në mënyrë të pandërgjegjshme, pa qenë në gjendje të di nëse e kam lexuar?
- Mua më kanë siguruar nga shumë anë, - tha Tola'at Shani me ngurrim, - se ky libër është më i miri deri më tani, të paktën sa i përket rrjedhshmërisë.
Ngrita sytë lart, duke i dhënë të kuptonte se po mendohesha për të vlerësuar gjithë krijimtarinë e mëparshme të autorit të ri premtues, me një shikim të vetëm, edhe pse ende nuk kam lexuar ndonjë rresht nga ai. E pse do të duhej të lexoja? Kush është ky Tola'at Shani? Pse m'i dërgonte librat e tij? Mirëpo, kjo ndodh vetëm për hir të mirësjelljes.
- Nuk do të thosha menjëherë se libri juaj është më i miri. Por, sigurisht, se është më intriguesi!
Këtu Tola'at Shani u struk. Pa dyshim, e kisha kapur në pikën e tij më të ndjeshme. Ndjeva keqardhje. Mos ndoshta unë duhet të përmbahesha, për hir të mirësjelljes improvizuese, që ai ta livadhiste diletantizmin e tij?
- E dija këtë! Për Zotin, e dija këtë! - Hidhërimi i diletantit, i përfshirë nga mendjemadhësia, u duk në zërin e tij.
- E keni fjalën për darkën në shtëpinë e komandantit të njësitit sulmues, apo jo? Mund të betohem se shovinizmi juaj bazohet në këtë skenë. Ndoshta unë do të duhej t'i përmblidhja të gjitha ngjarjet në këtë luginë malore, të goditur nga përmbytja, që të ishin më tërheqëse gjatë leximit? Nëse e mbani mend...
- Mos belbëzoni, - i tërhoqa vëmendjen. - Durimi im ka kufi.
- A ju kujtohet përshkrimi i garës së deveve gjatë natës rreth haremit të sheikut? Ai rrëfim duhet t'ju ketë pëlqyer, apo jo?
- Patjetër, shumë! Ajo ishte një skenë me shumë ngjyra.
- ... Dhe se Jekaterina theu llambën e tavolinës në kokën e gjyqtarit? A pajtoheni edhe ju me këtë?
- Kjo varet nga rrethanat.
- Atëherë ju nuk do të mund ta kundërshtonit fatin, që unë sajova për Meir-Kronstadtin dhe sojin e tij!
Kjo më shkaktoi irritime dridhëruese. "Opaaa, djalë i ri, - mendova. - Ti mund të bëhesh serioz, kur do, por Meir-Kronstadtin mos ma kritiko!"
E gjithë rrjedha e bisedës më zagushiti. Ishte shumë e përçartë. Tani shkëndijat duhet të fluturonin. Tani vetëpërmbajtjes sime po i vinte fundi.
- Dëgjoni, Tola'at Shani! Nëse unë do të isha në pozitën tuaj, nuk do të isha kaq krenar për çështje që kanë të bëjnë me Meir-Kronstadtin.
- Megjithatë, unë jam krenar.
Gjaku më hipi në kokë. E pabesueshme. Ky djalosh po guxonte të më kundërshtonte.
- Kronstadti është një mashtrues, - i thashë ashpër. - Ajo që bën ai nuk bind askënd. Më shumë se kaq: ai është i tepërt. Ju mund ta hiqni plotësisht, pa dëmtuar librin.
- Dhe si, nëse mund t'ju pyes? Atëherë do të duhej të përgatis një konflikt tjetër? Mirë! Por si? Çfarë mendoni ju?
- Ndoshta ju mendoni për zoologun.
- Për kë tjetër?
- Dhe Jekaterinën?
- Duhet të shkojë me gjyqtarin!
- Në muajin e nëntë?
- Pastaj?
- A nuk mendoni se është paksa e thjeshtësuar? Përveç kësaj, ju duket se harroni që Jekaterina goditet nga një makinë!
- A duhet vërtet të goditet ajo? Sidomos ajo? Nëse dikush duhet të goditet, atëherë ajo duhet të jetë Abigaili.
- Qesharake. Çfarë kuptimi do të kishte?
Kjo ishte e tepërt për mua. Kjo nuk duhej t'i thuhej një specialisti si unë. Pothuajse që tridhjetë vjet unë vazhdimisht lexoj libra dhe tani një amator guxon të më thotë "qesharake".
- Thatë "qesharake"?! Ju, amator? Dhe gara juaj idioteske e deveve nuk qenkësh ndoshta qesharake? Çfarë po them: qesharake. Është e neveritshme! Kam pasur probleme, që të mos villja gjatë leximit!
- Brilante! Ky ishte pikërisht qëllimi që kisha menduar. Një person që neveritet, të paktën e njeh veten. Dhe unë po ju mendoj Ju!
Ne tashmë kishim hyrë në fushën e paparashikueshme të ofendimeve personale. Tola'at Shani ishte zverdhur nga zemërimi.
Frymëmarrja e tij ishte bërë ngufatëse.
- Do t'ju tregoj se çfarë nuk ju pëlqen Juve në librin tim, - foli rrëmbyeshëm.
- Që unë kam guxuar të heq dorë nga zgjidhjet banale. Se unë nuk e lashë Borisin të zhdukej në përmbytje. E saktë?
Borisi! Edhe ai më mungonte tani.
- Shkoni në ferr, ju me Borisin tuaj! - e mallkova. - Ju jeni vënë në shërbim të atij vagabondi! Dhe nëse doni ta dini, afera e tij e dashurisë me Abigailin është krejtësisht e parëndësishme.
- E parëndësishme! - ofshau autori i ri premtues.
- Ajo duhej t'i përkiste dikujt!
- Por... vetëm Borisit jo! A nuk kishte ndonjë tjetër?
- Cilin? - Tola'at Shani m'u hodh mua, më kapi për jake dhe më shkundi. - Cilin?
- Sa më përket mua, zoologut, si e kishte emrin, Kronstadti!
- Kronstadti nuk është zoolog.
- Ai është një zoolog! Dhe nëse jo Kronstadti, atëherë komandanti i njësitit sulmues.
- Kronstadti është komandant i njësitit sulmues.
- Ja, pra! Sa më përket mua, ai mund të jetë cilido që dëshiron. Ai mund të jetë kushdo, vetëm Borisi jo! Madje edhe atasheu detar do të ishte më e logjikshme! Ose Pjetri! Ose Birnabaumi!
- Kush është Birnbaumi?
- Ai nuk është më i keq se Kronstadti, ju garantoj! Me gjasë ju besoni se është e mjaftueshme që duke gërvishtur letra shkruhet një libër. Kujdes! Po me ngjarjet, si janë shtjelluar? Karakteret? Me konfliktet e brendshme? Me thellësinë?
Tani isha unë ai që po e ngufasja atë.
